



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONERI PËR MBROJTJEN NGA DISKRIMINIMI

Nr. 536/7 prot.

Tiranë, më 27. 06. 2024

V E N D I M

Nr. 188, datë 27. 06. 2024

Mbështetur në ligjin nr. 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, pranë Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi¹ është regjistruar ankesa nr. 70 Regj., datë 03.04.2024, e Sindikatës së Gardës së Republikës së Shqipërisë, në cilësinë e përfaqësueses së grupit të personave², anëtarë të saj, kundër Gardës së Republikës, me pretendimin e diskriminimit për shkak të *bindjeve filozofike, përkatësisë në një grup të veçantë*³ dhe *çdo shkak tjetër*⁴.

Në përfundim të shqyrtimit të ankesës, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

K O N S T A T O I:

I. Parashtrimi i fakteve sipas subjektit ankues.

Subjektet ankues, të cilët bëjnë pjesë në Sindikatën e Gardës së Republikës së Shqipërisë, në ankesën e paraqitur pranë KMD-së, ndër të tjera, kanë parashtruar se: *“Ne, anëtarët e Sindikatës së Gardës së Republikës së Shqipërisë, e cila është miratuar si entitet ligjor nga Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, me vendimin nr. 4, në datën 20.02.2024, shkruajmë këtë letër për të ngritur shqetësimet dhe për t’ju njohur me presionet që po përjetojmë nga punëdhënësi ynë, Garda e Republikës.*

Pas miratimit të sindikatës tonë, kemi hasur në një sërë sfidash dhe pengesash që cenojnë të drejtat dhe mirëqenien e anëtarëve tanë. Këto përfshijnë thirrjet që u janë bërë anëtarëve të sindikatës në Drejtorinë e Përgjithshme të Gardës duke i vënë përballë:

- *Kërcënimeve për shkarkim nga puna;*
- *Ndëshkime me masa disiplinore;*
- *Pyetje për mënyrën e firmosjes para Noterit Publik;*

¹ Në vijim do t’i referohemi me akronimin KMD ose Komisioneri.

² Inspektor G. H., Inspektor H. P., Inspektor G. M., Komisar B. N., Inspektore M. H., Inspektor F. I. dhe Inspektor M. G.

³ Si pjesë e Sindikatës së Gardës së Republikës së Shqipërisë.

⁴ Pa përcaktuar një cilësi apo karakteristike që mbart subjekti ankues.

- Dhe pse jeni bashkuar një nisme të tillë.

Këto veprime nga ana e Gardës së Republikës, jo vetëm që cenojnë marrëdhëniet e punës dhe krijojnë një mjedis pune toksik, por ato gjithashtu përbëjnë shkelje të të drejtave të punëtorëve të garantuara nga: Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë, Kodi i Punës, Ligjet dhe Konventat Evropiane ku Shqipëria aderon...”

Në përfundim të shqyrtimit të ankesës së saj pranë Komisionerit subjekti ankues/grupi i personave⁵, anëtarë të Sindikatës së Gardës së Republikës së Shqipërisë, ka kërkuar të konstatohet diskriminimi kundrejt këtij grupi të veçantë nga Garda e Republikës, për shkak të bindjeve filozofike, përkatësisë në një grup të veçantë, si dhe të merren masa për:

- Respektimin e të drejtave të anëtarëve të Sindikatës së Gardës së Republikës së Shqipërisë;
- Ndalimin e çdo shkelje që adresohet ndaj anëtarëve të sindikatës;
- Gjetjen e një zgjidhje të qëndrueshme mes sindikatës dhe punëdhënësit, në mbrojtje të interesave të punonjësve të Gardës së Republikës, për ti siguruar atyre një mjedis të shëndetshëm dhe të sigurtë;
- Ndalimin e veprimeve apo masave ndëshkimore diskriminuese për shkak të anëtarësimit në Sindikatën e Gardës së Republikës së Shqipërisë.

II. Ndjekja e procedurës për shqyrtimin e ankesës nga Komisioneri.

Në nenin 1 të LMD-së, parashikohet objekti i këtij ligji, duke u sanksionuar se: *“Ky ligj rregullon zbatimin dhe respektimin e parimit të barazisë dhe mosdiskriminimit në lidhje me racën, etninë, ngjyrën, gjuhën, shtetësinë, bindjet politike, fetare ose filozofike, gjendjen ekonomike, arsimore ose shoqërore, gjininë, identitetin gjinor, orientimin seksual, karakteristikat e seksit, jetesën me HIV/AIDS, shtatzëninë, përkatësinë prindërore, përgjegjësinë prindërore, moshën, gjendjen familjare ose martesore, gjendjen civile, vendbanimin, gjendjen shëndetësore, predispozicionet gjenetike, pamjen e jashtme, aftësinë e kufizuar, përkatësinë në një grup të veçantë, ose me çdo shkak tjetër”.*

Neni 7 i LMD-së, në pikën 1 të tij, parashikon se: *“Çdo veprim apo mosveprim i autoriteteve publike ose i personave fizikë a juridikë që marrin pjesë në jetën dhe sektorët publikë apo privatë, që krijojnë baza për mohimin e barazisë ndaj një personi apo grupi personash, ose që i ekspozon ata ndaj një trajtimi të padrejtë dhe jo të barabartë, kur ata ndodhen në rrethana të njëjta apo të ngjashme, në krahasim me persona të tjerë apo grupe personash, përbën diskriminim”.*

Plotësimi i kriterëve formale të një ankese, për të vijuar me shqyrtimin administrativ të saj, është hapi i parë, që ndiqet nga Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, në bazë parashikimeve përkatëse ligjore. Ky detyrim i Komisionerit parashikohet shprehimisht në ligjin nr. 10221, datë

⁵ Inspektor G. H., Inspektor H. P., Inspektor G. M., Komisar B. N., Inspektore M. H., Inspektor F. I. dhe Inspektor M. G.

04.02.2010 “Për Mbrotjtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, si dhe në ligjin nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”.

Mbështetur në parashikimin e nenit 44, pika 2, të ligjit nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, organi publik shqyrton paraprakisht kërkesën e depozituar nga pala, lidhur me përmbushjen e kriterëve formale ligjore, si kompetenca e organit publik, legjitimimi, afati, forma dhe çdo kriter tjetër të parashikuar nga ligji.

Në nenin 65, shkronja b), të ligjit të sipërpërmendur parashikohet gjithashtu se: “Në fillim të procedurës administrative, organi publik kryen verifikimet e mëposhtme:

.....

b) legjitimimin e palës që ka paraqitur kërkesën për fillimin e procedurës administrative.”

Ankuesit legjitimohen *ratione personae*, në kuptim të nenit 4, pika 1, nenit 33, pika 1, të LMD dhe nenit 3, pika 7, të Kodit të Procedurave Administrative, që t’i drejtohet Komisionerit me ankesë dhe ka provuar interesin e tyre të drejtpërdrejtë përsa i takon pretendimit për cenim të parimit të barazisë e mosdiskriminimit.

Subjekti kundër të cilit është paraqitur ankesa, Garda e Republikës, në cilësinë e punëdhënësit, është institucion i administratës shtetërore, person juridik, në varësi të ministrit përgjegjës për çështjet e rendit dhe sigurisë publike, e cila funksionon në bazë të ligjit nr. 33/2021 “Për Gardën e Republikës së Shqipërisë”. Misioni i Gardës së Republikës është garantimi i sigurisë së personaliteteve shtetërore dhe objekteve në ruajtje, mision i cili nuk ndryshon në gjendje të fatkeqësisë natyrore, të jashtëzakonshme ose në gjendje lufte.

Gjatë ushtrimit të aktivitetit të saj, Garda e Republikës ka hyrë në një marrëdhënie juridike punësimi me ankuesit. Në rastin në fjalë, Komisioneri konsideron se kemi të bëjmë me një marrëdhënie pune midis shtetit dhe individit.

Ankuesit legjitimohen *ratione temporis*, në kuptim të nenit 33, pika 4, shkronja “dh”, të LMD-së, pasi masat disiplinore të marra ndaj tyre kanë ndodhur gjatë muajit maj 2024, ndërsa ankesa pranë Komisionerit është regjistruar në datën 03.04.2024.

Sindikata e Gardës së Republikës së Shqipërisë, e cila ka paraqitur ankesë në emër të anëtarëve të saj, legjitimohet *ratione materia*, pasi pretendimi i saj është i tillë që bën pjesë në kompetencat që ligji, i njeh Komisionerit për shqyrtimin e ankesës në kuptim të nenit 32, pika 1, shkronja “a”, të LMD-së, ku përcaktohet se: “1. Komisioneri ka kompetencë: a) të shqyrtojë ankesat nga personat ose grupet e personave që pretendojnë se janë diskriminuar, siç parashikohet në këtë ligj;”

Referuar Vendimit të Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, me nr. 4, datë 20.02.2024, nëpërmjet së cilit Sindikata e Gardës së Republikës së Shqipërisë (GRSH), është regjistruar si person juridik, si dhe Statutit të saj, konstatohet se qëllimi dhe fusha e veprimtarisë së

kësaj organizate është ndër të tjera të fuqizojë lëvizjen sindikale për mbrojtjen e lirive dhe të drejtave sindikate të pjesëtarëve dhe punonjësve të tjerë të Gardës së Republikës së Shqipërisë.

Referuar Vendimit të Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, me nr. 4, datë 20.02.2024, si dhe Statutit të Sindikatës së GRSH, B. N. është zgjedhur Kryetar i Sindikatës së Gardës së Republikës së Shqipërisë, e cili bazuar në kompetencat e parashikuara në nenin 31, gjerat a) dhe b), të Statutit, ka tagrin e përfaqësimit të Sindikatës në marrëdhënie me persona të tretë dhe në çështje juridike etj.

Në këtë kontekst, theksojmë faktin se në bazë të pikës 1, të nenit 4, të ligjit nr. 10221, datë 04.02.2010 *“Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”*, të ndryshuar, ky ligj zbatohet për të gjithë personat, që jetojnë dhe qëndrojnë në territorin e Republikës së Shqipërisë, të cilët janë e ndjehen pjesë e grupeve të mbrojtura nga kjo Sindikatë. Mbështetur në objektin e veprimtarisë së Sindikatës, sipërcituar në vendim, Komisioneri gjykon se Sindikata, përfaqësuar nga B. N. (Kryetar i Sindikatës) legjitimohet dhe ka tagër për të bërë ankesë në emër të saj dhe anëtarëve që ajo përfaqëson.

Referuar nenit 33, të LMD, ankesa përmban elementët e kërkuar nga ky ligj për pranimin e saj dhe shqyrtimin në themel të pretendimeve të parashtruara nga pala ankuese.

Në zbatim të parashikimeve ligjore, të përcaktuara në nenet 32 dhe 33, të LMD-së, Komisioneri ka shqyrtuar çështjen duke ndërmarrë hapat si më poshtë:

1. Përmes shkresës nr. 536/1 prot., datë 09.04.2024, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi⁶ informoi dhe kërkoi informacion nga ana e Gardës së Republikës, lidhur me pretendimet e ngritura në ankesë nga ana e subjektit ankues.

Në përgjigje sa më sipërcituar, përmes shkresës⁷ nr. 1140 prot., datë 17.04.2024, Garda e Republikës vuri në dispozicion informacionin e kërkuar, duke sqaruar ndër të tjera se: *“...Në datën 11.03.2024. Garda vihet në dijeni nëpërmjet njoftimit të dërguar nga Komisar B. N. se Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë me kërkesën e një grupi prej 13 (trembëdhjetë) punonjësish të Gardës (nëntë prej tyre janë vartës të B. N. dhe tetë anëtarë janë ish punonjës), ka vendosur regjistrimin si person juridik të “Sindikatës së Gardës së Republikës të Shqipërisë”.*

Referuar faktit të mësipërm dhe bazuar në kuadrin rregullator ligjor e nënligjor, Garda e Republikës konstaton se veprimi i punonjësve të cilët firmosën kërkesën për krijimin e lëvizjes sindikaliste në Gardë bie ndesh me nenin 158, pika 13, shkronja “dh” e VKM me nr. 777, datë 15.12.2021 “Për miratimin e Rregullores së Gardës”, ku citohet: “Punonjësi i Gardës gjatë veprimtarisë së përditshme duhet të zbatojë normat e sjelljes si më poshtë: Të mos angazhohet dhe të mos marrë pjesë në asnjë veprimtari politike, partiake, sindikale, tubime, mitingje.”

⁶ Në vijim do t'i referohemi me akronimin KMD ose Komisioneri.

⁷ Protokolluar pranë Komisionerit me nr. 536/2 prot., datë 18.04.2024.

Në zbatim të nenit 55 dhe 56, pika 1 e ligjit nr. 33/2021, datë 15.03.2021 “Për Gardën e Republikës së Shqipërisë”, i cili citon: “Shkelje disiplinore është çdo veprim ose mosveprim i punonjësit, që bie në kundërshtim me këtë ligj dhe Rregulloren e Gardës”, krijohet bindja e arsyeshme se veprimi punonjësve gardist (firmosja e kërkesës për regjistrimin e “Sindikatës së Gardës së Republikës të Shqipërisë”), është lëvizje sindikaliste e cila përbën shkelje disiplinore dhe detyrimisht duhet t’i nënshtrohet procesit të hetimit disiplinor në përputhje me përcaktimet në rregulloren e Gardës dhe Kodit të Procedurave Administrative.

Detyrimi për kryerjen e hetimit disiplinor, bazohet në nenin 5, pika 1 e Rregullores së Gardës “Përgjegjësitë e zbatimit të rregullave”, në të cilin citohet: “Rregullat e brendshme janë të detyrueshme për të gjithë punonjësit e Gardës, pavarësisht nga hierarkia, funksioni apo struktura, në të cilën bëjnë pjesë”, si dhe në nenin 139, pika 7 e Rregullores së Gardës “Hetimi disiplinor, kuptimi dhe kritere të përgjithshme”, në të cilin punonjësit bëhen subjekte të shkeljes disiplinore, ku citohet: “Punonjësit i fillon hetimi disiplinor për moszbatimin e procedurave standarde të punës dhe shkeljet që kryejnë ata gjatë dhe jashtë kryerjes së detyrës”.

Dispozita në Rregulloren e Gardës që ndalon kufizimin e lëvizjes sindikaliste është e njëjta dispozitë që ndalon veprimtari politike, partiake, tubime, mitingje.

Bazuar në faktet dhe rrethanat e mësipërme, Garda ka detyrim ligjor të garantojë zbatimin e kuadrit rregullator ligjor e nënligjor nga të gjithë punonjësit e saj, duke kryer ecurinë disiplinore për të 13 (trembëdhjetë) punonjësit të cilët nga ana subjektive me dashje konsumuan elementët e shkeljes disiplinore të kategorisë: “Shkelje e lehtë”.

Gjatë hetimit disiplinor, nga struktura përkatëse u zbuluan të gjitha procedurat për një proces të rregullt sipas përcaktimeve në rregulloren e Gardës dhe në kodin e Procedurave Administrative.

Theksojmë se Garda e Republikës hetimin disiplinor e ka nisur ndaj punonjësve të saj për veprimet e tyre në raport me zbatimin e ligjit organik dhe Rregullores së Gardës dhe jo ndaj sindikatës si person juridik.

Në lidhje me kërkesat e parashtruara nga ju, përse i përket pretendimeve të ngritura nga disa punonjës të Gardës në institucionin tuaj, ju informojmë se:

- Pretendimi se punonjësit ndihen të kërcënuar për largime nga puna, është i pavërtetë, pasi ata deklarojnë gjatë intervistimeve në kuadër të hetimit disiplinor se nuk janë vendosur nën presion për largime nga puna.
- Nuk ka pyetje gjatë intervistimit për mënyrën e firmosjes para noterit.
- Nuk ekziston asnjë pyetje e tillë: “Përse jeni bashkuar në një nismë të tillë?”, që të jetë jashtë objektit të hetimit disiplinor.

Intervistimet e tyre me vullnet të lirë duke ju krijuar mundësinë që ata të paraqiten edhe me përfaqësues ligjor, vërtetojmë faktin se ndaj tyre nuk është ushtruar asnjë presion për largime nga puna, duke kundërshtuar dhe rrëzuar qartësisht objektin e ankesës që ata kanë paraqitur pranë institucionit tuaj.

Qëndrimi i tyre kontradiktor, për rastin objekt ankimi, ngre dyshime për mungesë serioziteti nga ana e tyre ose për veprime me dashje të cilat ulin imazhin e institucionit të Gardës së Republikës në publik. Ky dyshim bazohet në intervistimet e tyre, si dhe në intervistën e dhënë nga Komisar B. N. gjatë hetimit disiplinor, ku pyetjes: “...a ju është bërë presion për largim nga detyra

nga eprorët tuaj dhe nëse po nga kush?”, ai iu përgjigj: “...jam ndier i presionuar (nën presion) nga eprorët e Sektorit të Standardeve Profesionale për faktin e thirrjes së punonjësve në hetim disiplinor, të cilët janë anëtarë të sindikatës...”, që tregon se ndaj tyre nuk është ushtruar asnjë presion.

Njoftimi nga Sektori i Standardeve Profesionale është detyrë funksionale e tyre dhe jo presion, fakt i cili pranohet edhe nga punonjësit e intervistuar H. P., M. G., G. M., G. H., A. Ll., se njoftimi për nisjen e hetimit disiplinor ndaj tyre përbën presion për largim nga puna, përkundrazi është procedurë normale dhe respekt. (lexo intervistimet e tyre)

Sjellim në vëmendje se çdo deklaram tjetër nga çdo punonjës i Gardës i pabazuar në fakte dhe prova, i cili ul imazhin në publik të punonjësve me gradë më të lartë apo institucionit të Gardës, duke bërë njoftime zyrtare jo të sakta për shkelje disiplinore të cilat dihet që nuk janë kryer, përbën shkelje disiplinore më vete, (referuar rregullores së Gardës, neni 171, shkronja “e”) i cili citon: “Bën njoftime zyrtare jo të sakta (gënjen), se një punonjës ka kryer shkelje disiplinore, duke qenë në dijeni se punonjësi nuk ka kryer shkelje disiplinore”.

Ky ankim nuk është rasti i vetëm që punonjësi i Gardës, bën njoftime zyrtare jo të sakta, duke gënjyer, me qëllim nisjen e hetimit disiplinor ndaj Gardës, pasi ata janë në dijeni se Garda po kryen detyrën funksionale e jo shkelje disiplinore. I njëjti material i pa vërtetë i është dërguar edhe Agjencisë së mbikëqyrjes Policore dhe Avokatit të Popullit.

I nderuar Komisioner, si përfundim, argumentojmë se:

1. Zbatimi i ligjshmërisë nga Garda e Republikës (neni 55, 56 i ligjit nr. 33/2021 “Për Gardën e Republikës së Shqipërisë”), për rastin objekt hetimi nga ana juaj, gjykojmë se nuk përbën diskriminim për shkak të bindjeve filozofike ndaj disa punonjësve të saj, pasi ata me veprimin e tyre shkelin dispozitat e Rregullore së Gardës të cilat janë të detyrueshme për tu zbatuar.
2. Deklarimet e punonjësve se ndaj tyre nuk është ushtruar presion për largime nga puna për shkak të krijimit të lëvizjes sindikaliste, tregojnë pavërtetësinë e ankimit të paraqitur pranë KMD-së dhe për rrjedhojë rrëzojnë objektin e “diskriminimit”, ose me dashje paraqesin fakte të rreme pranë institucionit tuaj me qëllim nisjen e hetimit administrativ për të ushtruar presion nëpërmjet KMD-së ndaj strukturës që po kryen hetimin disiplinor ndaj tyre. (ky fakt del qartë në intervistimin e Komisar B. N.)...”.

2. Me e-mail-in datë 18.04.2024, Komisioneri vuri në dispozicion të subjektit ankues, Sindikatës, përgjigjen Gardës së Republikës sipërcituar, si dhe kërkoi parashtrime shtesë sa i përket tyre.

Në përgjigje sa më sipër, me e-mail-in e datës 18.04.2024, Sindikata informoi Komisionerin ndër të tjera se: “I- Ata thonë që nuk po i ndëshkojmë si Sindikatë por po i ndëshkojmë që kanë marrë pjesë si firmëtarët e kërkesës drejtuar një institucioni Gjyqësor për shqyrtimin e kërkesës objekt “Krijimin e Sindikatës së Republikës së Shqipërisë”.

2- Në kthim përgjigje kanë mangësi në shumë raste por kjo pak rëndësi ka. Për mendimin tonë, thelbi i gjësë është se punonjësve po ju ushtrohet presion me këto metoda jo ligjore hetimi dje, dhe

tani ndëshkimi për të frenuar tjerët në këtë nismë ligjore. Madje dhe aktin administrativ “Vërejtje” nuk ju japin kopje për fatin që të skadojnë afatet e ankimimit në komision që është 5 ditë...

3- Interpretimin ligjor të lejimit në bazë të hierarkisë ligjore e ka shteruar Gjykata tashmë. Nëse ne do biem në grackën e tyre të interpretimit ligjor atëherë përse na u dashkan Gjykatat???

4- ...këtu po cenohen rëndë të drejtat themelore të punonjësve të Gardës në të drejtën e tyre kushtetuese.

5- ...Garda thotë po ndëshkoheni për thyerje të rregullores edhe pse gjykata ka qenë në dijeni të asaj pike që ata përmendin. Por në fund është kjo e fundit, Gjykata, që njeh ligjin hierarkik, procedural dhe flet në emër të Republikës bazuar në Kushtetutë etj. ”

3. Me e-mail-in datë 24.04.2024, Kryetari i Sindikatës, njoftoi Komisionerin se është vënë në dijeni nga ana e punëdhënësit se ndaj tij është marrë masë disiplinore “Përgjashtim nga Garda e Republikës”, ndërsa ndaj Kryetares së Gruas së Sindikatës ishte marrë masa disiplinore “Shtyrje e afatit në gradim për dy vjet”.
4. Me shkresën nr. 536/3 prot., datë 25.04.2024, Komisioneri informoi Gardën e Republikës lidhur me parashikimet e ligjit nr. 10221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, i cili përcakton se punëmarrësi gjatë periudhës së shqyrtimit të ankesës ka të drejtë të vazhdojë punën sipas kushteve të kontratës.
5. Gjithashtu, me shkresën nr. 536/4 prot., datë 25.04.2024, Komisioneri informoi dhe kërkoi informacion nga ana e Këshillit të Ministrave dhe Ministrisë së Brendshme, lidhur me pretendimet e ngritura në ankesë nga ana e Sindikatës, si dhe relacionin shpjegues sa i përket miratimit të VKM-së nr. 777, datë 15.12.2021 “Për miratimin e Rregullores së Gardës”.

Në përgjigje⁸ sa më sipër, Garda e Republikës me shkresën⁹ nr. 1368/4 prot., datë 07.05.2024, informoi ndër të tjera Komisionerin se: “...Referuar kontratës së punës lidhur në datën 01.10.2018 mes punëdhënësit Garda e Republikës dhe punëmarrësit B. N., neni 11, pika 1, germa “h” citon: “kjo kontratë konsiderohet e zgjidhur automatikisht kur punonjësi i Gardës përjashtohet për shkaqe të parashikuara në ligjin organik të Gardës së Republikës”.

- a) B. N. është ndëshkuar me masën e rëndë disiplinore “Përgjashtim nga Garda e Republikës” me motivacionin: “Ka cenuar rëndë integritetin e institucionit”, për shkak se ka dhënë intervistë të paautorizuar në media audiovizive ku ka dhënë deklaratime të pavërteta dhe të pabazuara në fakte dhe prova për Gardën e Republikës duke cenuar rëndë integritetin e saj. Për pjesëmarrjen e tij në lëvizje sindikaliste nuk i është dhënë asnjë masë disiplinore për shkak të kalimit të afateve procedurale.
- b) M. H. është ndëshkuar me masën e rëndë disiplinore “Shtyrje e afatit të gradimit për 2 vjet”, me motivacionin “ka kryer veprime që cenojnë dinjitetin e institucionit”, për shkak se ka dhënë intervistë të paautorizuar në media audiovizive duke cenuar dinjitetin e

⁸ Të cilën Komisioneri përmes e-mail-it datë 10.05.2024, ja përcolli subjektit ankues.

⁹ Protokolluar pranë Komisionerit me nr. 536/5 prot., datë 09.05.2024.

institucionit. Ndërsa për shkak të shkeljes të nenit 158, pika 13, germa “dh” e VKM 777, datë 15.12.2021 “Për miratimin e Rregullores së Gardës” është ndëshkuar me masën e lehtë disiplinore “vërejtje”

Dhënia e masave të rënda disiplinore për këta dy punonjës nuk ka lidhje me objektin e ankesës që po shqyrtohet nga ana juaj”.

Në përgjigje¹⁰ sa më sipër, Ministria e Brendshme me shkresën¹¹ nr. 2915/9 prot., datë 16.05.2024, informoi ndër të tjera Komisionerin se: “...Referuar hierarkisë së normave juridike të parashikuara nga neni 116 i Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, në krye të tyre qëndron Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë, pastaj vijnë marrëveshjet ndërkombëtare të ratifikuara, ligjet dhe pastaj aktet normative të Këshillit të Ministrave.

Kushtetuta në Nenin 50 të saj sanksionon “Të punësuarit kanë të drejtë të bashkohen lirisht në organizata sindikale për mbrojtjen e interesave të tyre të punës”. Referuar nenit 11 të Ligjit 33/2021 “Për Gardën e Republikës së Shqipërisë”, parashikohen kufizimet për punonjësit e Gardës, ku liria sindikale nuk i kufizohet.

Sipas nenit 51 të Kushtetutës i cili garanton të drejtën e të punësuarit për grevë, parashikohen gjithashtu kufizime për kategori të veçanta të punësuarish, që mund të vendosen me ligj, për ti siguruar shoqërisë shërbimet e domosdoshme. Në zbatim të këtij parashikimi, Ligji 33/2021 ka parashikuar se punonjësit të Gardës i kufizohet pjesëmarrja në grevë, por jo liria sindikale.

I tillë është edhe qëllimi i VKM-së Nr. 777, datë 15.12.2021 “Për miratimin e rregullores së Gardës së Republikës së Shqipërisë”, i cili është një akt normativ i Këshillit të Ministrave, i nxjerrë në bazë të autorizimit të dhënë nga ligji i posaçëm 33/2021 “Për Gardën e Republikës së Shqipërisë” dhe për zbatim të këtij ligji.

Gjithashtu, Ministria e Brendshme pasi është njohur me ankesat e Sindikatës së Gardës së Republikës së Shqipërisë, ka nisur një proces vlerësimi për dispozitën për të cilën pretendohet se cenon lirinë sindikale, pavarësisht qëllimit të saj.

Në vijim të arsyetimit të sipërcituar, në asnjë nga aktet nënligjore të propozuara nga Ministria e Brendshme, nuk ka patur si qëllim shkeljen e të drejtave të individëve, të njohura nga aktet me fuqi juridike më të lartë. Ministria e Brendshme gjatë veprimtarisë së saj ka në konsideratë ligjshmërinë dhe përshtatshmërinë e veprimeve administrative, si dhe vepron në përputhje me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, me marrëveshjet ndërkombëtare të ratifikuara dhe legjislacionin e zbatueshëm në Republikën e Shqipërisë. brenda kufijve të kompetencave të tyre dhe në përputhje me qëllimin për të cilin janë dhënë këto kompetenca.

Përveç sa më sipër, Ministria e Brendshme me shkresën Nr. 2915/3 prot., datë 04.04.2024, si dhe me korrespondencën zyrtare në vijim, i ka bërë me dije Gardës së Republikës së Shqipërisë se referuar Kushtetutës, Kodit të Punës, Ligjit për Sindikatat në Republikën e Shqipërisë, të punësuarit kanë të drejtë të bashkohen lirisht në organizata sindikale, si dhe në zbatim të neneve 22 dhe 23 të ligjit 90/2012 “Për Organizimin dhe Funksionimin e Administratës Shtetërore”, është

¹⁰ Të cilën Komisioneri përmes e-mail-it datë 22.05.2024, ja përcolli subjektit ankues.

¹¹ Protokolluar pranë Komisionerit me nr. 536/6 prot., datë 21.05.2024.

kërkuar marrja e masave nga ana e Gardës, si institucioni në cilësinë e punëdhënësit, për zbatimin e legjislacionit në fuqi për funksionimin e organizatave sindikale.”.

6. Me anë të e-mail-it datë 09.05.2024, Sindikata e Gardës së Republikës së Shqipërisë, depozitoi parashtrime shtesë lidhur me pretendimet e ngritura nga ana e Gardës së Republikës. Ndër të tjera nga ana e Sindikatës u theksua se:

“...Më tej të nderuar ka vijuar i njëjti skenar, vetëm e vetëm se ndërhyrjet e presionet ndaj anëtarëve të sindikatës përfshirë organet drejtuese të saj kanë agravuar më shumë. Si rrjedhojë e tyre është konkluduar nga Drejtuesi i parë D. O. dhe Kryekomisar J. S. dhe me miratim të Drejtorit Përgjithshëm të Gardës G. S., në marrjen e atyre masave disiplinore “Vërejtje” ndaj të gjithë anëtarëve Sindikatës, dhe duke përjashtuar nga Garda Drejtuesit e saj...

Me këtë vendim të Drejtuesit Madhor të Gardës së Republikës së Shqipërisë, nuk jemi dakord dhe e kundërshtojmë atë, brenda afateve ligjore 10 ditë, si një vendimmarrje e marrë në kundërshtim me dispozitat ligjore procedurale dhe ato materiale në fuqi për arsyet si më poshtë:

Së pari, situata faktike e pretenduar në aktin objekt ankimi është e pavërtetë. Në datë 25.03.2024, Komisar B. N. në cilësinë e Presidentit të Sindikatës së Gardës së Republikës ka dhënë një intervistë në median audiovizive televizive “MCN” ku ka folur për të drejtat e punonjësve të Gardës së Republikës me këtë përmbajtje: “Një pjesë dërrmuese e punonjësve të gardës së Republikës mos themi 70% e tyre janë në punë edhe gjatë festave zyrtare, për të cilat në bazë të Kodit të Punës, duhet të paguhet me 150% të pagës (nënkupton 100% + 50%). Plus asaj duhet të marrin edhe jo më vonë se tre ditë të javës pasardhëse pushimin që i takon. Ky detyrim nuk përmbushet nga punëdhënësi në rastin konkret nga Garda e Republikës. Shërbimet e Gardës kanë një numër të konsiderueshëm punonjësish që janë në punë 24 orë me turne kuptohet, dhe shpërblimi i tyre konform Kodit të Punës është i cunuar”

Nga ky tekst rezulton qartësisht se Presidenti i Sindikatës së Gardës së Republikës, ndryshe nga sa pretendohet, nuk ka cenuar integritetin e Institucionit, dhe aq më pak të ketë përmendur emrin e ndonjë drejtuesi apo eprori të këtij institucioni. Por, nga ana e tij është bërë me dije se të drejtat e parashikuar nga ligji në lidhje me shpërblimin e punonjësve nuk respektohen. Ky fakt i pretenduar nga Presidenti i Sindikatës është i vërtetë dhe i pamohueshëm.

Së dyti, për këtë mjafton të shohim pagën e secilit punonjës ku në atë nuk reflektohet (zëri për të cilin unë citoj) “pagesa e parashikuar nga ligji për orët e punës të kryera prej punonjësve në ditët e pushimit javorë ose në festat zyrtare”...

Së treti, kjo intervistë ndryshe nga sa pretendohet, është dhënë në një moment kur Komisar B. N. ka qenë pushim dhe nuk ka qenë në detyrë ashtu siç pretendohet (referuar pika “c” neni 167 nga ana juaj). Por në çdo rast intervista ose komunikimi me median nuk ka pasur për objekt veprimtarinë e gardës, por është dhënë në ushtrim të të drejtave dhe detyrave funksionale si President i Sindikatës së Gardës, me qëllim respektimin e të drejtave që ligji parashikon për çdo punonjës të këtij institucioni. E për rrjedhojë çdo pretendim se kjo intervistë është dhënë pa autorizimin e Drejtorit të Përgjithshëm të Gardës është i paligjshëm për sa kohë aktiviteti

sindikatës është jo vetëm një e drejtë Kushtetuese (neni 50), por edhe një e drejtë e sanksionuar me vendim të Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë.

Nëse s'do të ishte kështu, atëherë aktiviteti i Sindikatës së Gardës së Republikës duhet të rregullohet me autorizim të Drejtorit të Përgjithshëm të Gardës? Dhe nëse drejtori nuk e jep autorizimin atëherë sindikata nuk vepron?

Së katërti, vendimi objekt ankimi është marrë në shkelje të rëndë me dispozitat e Kodit të Punës, nenit 181, pika 3 dhe 4, si dhe nenit 186, pika 1, geramat b) dhe c).

Gjithashtu, në Statutin e Sindikatës miratuar nga Gjykata në nenin 11 pika 2 e 13 (qëllimi i veprimtarisë Sindikatës) është:

2- Mbrojtja dhe garantimi i të drejtës së punës në përputhje me kodin e punës.

13- Ndihmë juridike dhe përfaqësim falas i anëtarëve të sindikatës në mbrojtje të të drejtave dhe interesave të tyre legjitime që rrjedhin nga pasoja e neglizhencës të punëdhënësit kundrejt vartësve të tyre.

Referuar vendimit objekt ankimi, rezulton se parashikimet e dispozitave Kushtetuese, ligjore të mësipërme janë shkelur qoftë për sa i përket diskriminimit që i është bërë Presidentit të Sindikatës së Gardës së Republikës, dhe qoftë për sa i përket procedurës që parashikon ligji për zgjidhjen e marrëdhënies së punës me përfaqësuesin e sindikatës.

Së pesti, vendimi objekt ankimi është marrë në kundërshtim me Nenin. 4 të ligjit Nr. 33/2021 të GRSH-së i cili parashikon si vijon: “Neni 4 shkronjat “a”, “b”, “c”, “Parimet e veprimtarisë”:

Parimet bazë të organizimit dhe funksionimit të Gardës së Republikës janë:

a) ligjshmëria;

b) mosdiskriminimi;

c) respektimi i të drejtave dhe lirive themelore të njeriut;

Neni 148 pika 5 dhe 6 e VKM-së Nr. 777 datë: 15.12.2024

5. Punonjësi nuk mund të ndëshkohet me masë, për periudhën që është me leje apo me raport mjekësor..

6. Punonjësi nuk mund të ndëshkohet me masë, në qoftë se për të njëjtën shkelje është nën hetim disiplinor nga një organ apo strukturë më e lartë.”.

- Në datë 24.4.2024 kam qenë me leje vjetore, konkretisht (21-27.04.2024)

- Organi më i lartë që po heton rastin është Komisioneri i Mbrojtjes nga Diskriminimi.

Në këtë vështrim ankuesi ka bindjen se, vendimi objekt ankimi, Urdhër nr. 395 datë 24.04.2024 i Drejtorit të Përgjithshëm të Gardës së Republikës vjen në kundërshtim të hapur dhe flagrant me dispozitat e ligjit material në fuqi duke e bërë atë një akt të paligjshëm në kuptim të përcaktimeve të Kodit të Punës...

4- Ankimi për M. H.

Në datë 24.04.2024, ankuesi “Sindikata e Gardës së Republikës së Shqipërisë, është njohur me “Urdhër nr. 397, datë 24.04.2024 me nr. 1225 prot., datë 24.04.2024 të Drejtuesit Madhor të Gardës së Republikës së Shqipërisë nëpërmjet të cilit vihemi në dijeni sa citon:

“1. Inspektore M. H., me detyrë Trup shërbimi në sektorin e parë, në Drejtorin për sigurinë në organet e drejtësisë, t'i jepet masa disiplinore "Shtyrje e afatit të gradimit 2 vjet" me motivacionin, “ka kryer veprime që cenojnë dinjitetin e institucionit” (me veprimet e saj, ka konsumuar shkelje

disiplinore, e cila kategorizohet shkelje e rëndë disiplinore pasi në datën 25.03.2024 në kanalën televizivë “MCN” në edicionet e lajmeve është shfaqur duke dhënë intervistë pa patur autorizim nga Drejtori i Përgjithshëm i Gardës, duke cenuar rëndë dinjitetin e Institucionit të Gardës së Republikës në opinionin publik).

2. Ngarkohen për zbatim të këtij urdhëri, Drejtoria për sigurinë e organeve të drejtësisë dhe Sektori i Burimeve Njerëzore”.

Me këtë vendim të Drejtuesit Madhor të Gardës së Republikës së Shqipërisë, nuk jemi dakord dhe e kundërshtojmë atë, brenda afateve ligjore 10 ditë, si një vendimarrje e marrë në kundërshtim me dispozitat ligjore procedurale dhe ato materiale në fuqi për arsyet si më poshtë:

Së pari, situata faktike e pretenduar në aktin objekt ankimi është e pavërtetë. Në datë 25.03.2024, Inspektore M. H., në cilësinë e Kryetares së Gruas të Sindikatës së Gardës së Republikës ka dhënë një intervistë në median audiovizive televizive “MCN” ku ka folur për të drejtat e punonjësve të Gardës së Republikës. Ndër të tjera thekson se për femrat, puna në Gardën e Republikës është e rëndë pasi është me turne, por ka dhe vende tjera ku është pa turne e cila është më e lehtë. Nga ky tekst rezulton qartësisht se Kryetarja e Gruas e Sindikatës së Gardës së Republikës, ndryshe nga sa pretendohet, nuk ka cenuar rëndë integritetin e Institucionit.

Nga ana tjetër, kjo intervistë ndryshe nga sa pretendohet, është dhënë në një moment kur Inspektore M. H., nuk ka qenë në detyrë. Por në çdo rast intervista ose komunikimi me median nuk ka pasur për objekt veprimtarinë e gardës, por është dhënë në ushtrim të të drejtave dhe detyrave të saj funksionale si Kryetare e Gruas e Sindikatës së Gardës, me qëllim respektimin e të drejtave që ligji parashikon për çdo punonjës të këtij institucioni. E për rrjedhojë çdo pretendim se kjo intervistë është dhënë pa autorizimin e Drejtorit të Përgjithshëm të Gardës është i paligjshëm për sa kohë aktiviteti i sindikatës është jo vetëm një e drejtë Kushtetuese, (neni 50) por edhe një e drejtë e sanksionuar me vendim të Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë...

Nëse s’do të ishte kështu, atëherë aktiviteti i Sindikatës së Gardës së Republikës duhet të rregullohet me autorizim të Drejtorit të Përgjithshëm të Gardës? Dhe nëse drejtori nuk e jep autorizimin atëherë sindikata nuk vepron?

Së dyti, vendimi objekt ankimi është marrë në shkelje të rëndë me dispozitat e Kodit të Punës, nenit 181, pika 3 dhe 4, si dhe nenit 186, pika 1, germa b) dhe c).

Gjithashtu, në Statutin e Sindikatës miratuar nga Gjykata në nenin 11 pika 2 e 13 (qëllimi i veprimtarisë Sindikatës) është:

2- Mbrojtja dhe garantimi i të drejtës së punës në përputhje me kodin e punës.

13- Ndihmë juridike dhe përfaqësim falas i anëtarëve të sindikatës në mbrojtje të të drejtave dhe interesave të tyre legjitime që rrjedhin nga pasoja e neglizhencës të punëdhënësit kundrejt vartësve të tyre.

Referuar vendimit objekt ankimi, rezulton se parashikimet e dispozitave Kushtetuese, ligjore të mësipërme janë shkelur qoftë për sa i përket diskriminimit që i është bërë Presidentit të Sindikatës së Gardës së Republikës, dhe qoftë për sa i përket procedurës që parashikon ligji për zgjidhjen e marrëdhënies së punës me përfaqësuesin e sindikatës.

Së treti, vendimi objekt ankimi është marrë në kundërshtim me Nenin. 4 të ligjit Nr. 33/2021 të GRSH-së i cili parashikon si vijon: “Neni 4 shkronjat “a”, “b”, “c”, “Parimet e veprimtarisë”:

Parimet bazë të organizimit dhe funksionimit të Gardës së Republikës janë:

a) ligjshmëria;

b) mosdiskriminimi;

c) respektimi i të drejtave dhe lirive themelore të njeriut;

Neni 148 pika 5 dhe 6 e VKM-së Nr. 777 datë 15.12.2024:

5. Punonjësi nuk mund të ndëshkohet me masë, për periudhën që është me leje apo me raport mjekësor..

6. Punonjësi nuk mund të ndëshkohet me masë, në qoftë se për të njëjtën shkelje është nën hetim disiplinor nga një organ apo strukturë më e lartë.”

Në këtë vështrim ankuesi ka bindjen se, vendimi objekt ankimi, Urdhër nr. 397, datë 24.04.2024 i Drejtorit të Përgjithshëm të Gardës së Republikës vjen në kundërshtim të hapur dhe flagrant me Kushtetutën, Konventat Ndërkombëtare ku Shqipëria aderon, dispozitat e ligjit material në fuqi duke e bërë atë një akt të paligjshëm në kuptim të përcaktimeve të Kodit të Punës.

5- Ankimi ndaj Anëtarëve tjerë me masat ” Vërejtje”

Faktet dhe rrethanat.

I. Gjatë hetimit disiplinor rezultoi e provuar se ne, të akuzuarit, këtu e në vijimësi ndëshkuar me masat disiplinore “Vërejtje” jemi njohur (anëtarë) me personalitet Juridik “Sindikata Gardës së Republikës së Shqipërisë”, me përfaqësues ligjorë B. N. me Vendimin Nr. 4, të datës 20.02.2024 dhe Nr. 344 Regj. Themeltarë, Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, si dhe Vërtetimi nga zyra e regjistrimit të OJF-ve datë: 28.2.2024.

Vendim dhe vërtetim me të cilin kam njohur Drejtorin e Përgjithshëm të Gardës, me datë 08.03.2024 protokolluar me tonën nr. 2 dhe me postën shqiptare me kodin RR568654340AA.

II. Jemi njohur gjithashtu, me kthim përgjigje nga Ministria e Brendshme, nr. prot. 2915/3 të datës: 4.4.2024 pas ankesës (ndaj Gardës) që kishim adresuar pranë këtij Institucioni për kundërshtimet dhe interpretimin e legjitimitetit të krijimit të Sindikatës së Gardës së Republikës prej ku, nga këto të fundmit (Drejtuesit e Gardës) po hasnim vështirësi në mos njohje, duke kundërshtuar në mënyrë flagrante vendimin e gjykatës.

Për këto rrethana e fakte janë vënë në dijeni dhe Institucione të tjera jashtë Gardës së Republikës.

Për sa thamë më sipër,

Masat ndëshkimore të dhëna nga Garda, nuk përlijen me faktet e ndodhura, pasi ne si palë e penalizuar po zbatojmë vetëm një Vendim Gjykatë të formës së prerë konform objektit të saj, vendim ky në emër të Republikës dhe Kushtetutës së Shqipërisë.

Për këto shkaqe legjitime paraqitëm ankimimin në emër dhe për llogari të të gjithë punonjësve ndëshkuar me të pa drejtë nga ana e punëdhënësit me masën vërejtje.

Madje punonjësit e ndëshkuar në momentin e njohjes kundrejt nënshkrimit nuk pajisen me aktin administrativ “Vërejtje” konform K. Pr. Administrative. Ky fakt ndodhur në prezencën time, nga Kryekomisar A. H. e Drejtues E. M. ku punonjësit kanë varësi.

Për sa më sipër, mbështetur në prova dhe fakte të pakundërshtueshme kërkojmë nga ana juaj si Komisioner (KMD)

- Të pranoni kërkesën tonë duke shfuqizuar, këto masa ndëshkimore si të pa mbështetur në dispozitat ligjore të cituar më lart, madje duke kundërshtuar një vendim gjykatë të formës së prerë në diskriminim të hapur ndaj një grupi shoqëror bazuar në Ligjin nr. 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar.”

7. Me e-mail-in datë 23.05.2024, Sindikata informoi Komisionerin se Garda e Republikës i është drejtuar më datë 11.04.2024, me kërkesë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, me kërkesën me objekt: *“Mbi shpërndarjen e Sindikatës së Gardës së Republikës së Shqipërisë, e regjistruar si person juridik, me vendim nr. 4, datë 20.02.2024 të Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë”.*

8. Përmes e-mail-it datë 14.06.2024, Sindikata vuri në dispozicion të Komisionerit Rekomandimet e Avokatit të Popullit, drejtuar Gardës së Republikës dhe Këshillit të Ministrave.

Në përmbajtje të tyre, Avokati i Popullit, i ka rekomanduar Gardës së Republikës:

“Ndërprerjen e menjëhershme të veprimeve të strukturave drejtuese të gardës ndaj anëtarëve themelues të Sindikatës së Gardës së Republikës së Shqipërisë, të cilat pengojnë zhvillimin e veprimtarisë sindikale.

Shfuqizimin e menjëhershëm nga strukturat kompetente të masave disiplinore “Vërejtje” të dhëna ndaj anëtarëve themelues të Sindikatës së Gardës së Republikës së Shqipërisë”.

Ndërsa, ndaj Këshillit të Ministrave, Avokati i Popullit, kishte rekomanduar: *“Marrjen e masave të nevojshme për korrigjimin dhe përmirësimin e Rregullores së Gardës të Republikës së Shqipërisë, miratuar me VKM nr. 777, datë 15.12.2021 dhe konkretisht heqjen e fjalës “sindikale” në germën “dh”, pika 13 e nenit 158 të saj”.*

III. Vlerësimi i fakteve dhe provave të grumbulluara nga Komisioneri gjatë procesit të shqyrtimit të çështjes.

Ligji 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, i ndryshuar, në nenin 1 dhe nenin 3/1, parashikojnë se: *“ “Diskriminim” është çdo dallim, përjashtim, kufizim ose preferencë, bazuar në cilindo shkak të përmendur në nenin 1 të këtij ligji, që ka si qëllim ose pasojë pengesën ose bërjen të pamundur të ushtrimit në të njëjtën mënyrë me të tjerët, të të drejtave e lirive themelore të njohura nga Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë, aktet ndërkombëtare të ratifikuara nga Republika e Shqipërisë, si dhe nga ligjet në fuqi”.*

Gjatë shqyrtimit të ankesës dhe ndjekjes së procedurës hetimore, Komisioneri në përputhje me ligjin ka kërkuar informacionin e nevojshëm dhe dokumentacionin mbështetës, lidhur me rastin e

subjektit ankues, në mënyrë që të mund të vlerësonte me objektivitet pretendimin e tij për trajtim të pa drejtë dhe diskriminues.

Komisioneri ka përmbushur kërkesat e parashikuara në Kodin e Procedurës Administrative, edhe sa i takon dhënies së ndihmës efektive, gjë e cila është përcaktuar në nenin 10, të tij: *“Organi publik siguron që të gjitha palët dhe persona të tjerë të përfshirë në procedurë të jenë në gjendje të ndjekin dhe të mbrojnë të drejtat dhe interesat e tyre ligjorë në mënyrë sa më efektive dhe të lehtë të jetë e mundur. Ai i informon palët mbi të drejtat dhe detyrimet e tyre, përfshirë të gjithë informacionin e lidhur me procedurën dhe i paralajmëron ato për pasojat ligjore të veprimeve ose mosveprimeve të tyre”*.

LMD, në nenin 32, pikën 2, të tij ka përcaktuar qartë këtë detyrim, duke cituar se: *“Të gjitha institucionet publike dhe subjektet private janë të detyruara të mbështesin Komisionerin, duke i dhënë informacionin që i nevojitet dhe duke i garantuar aksesin në informacionin në përmbushjen e detyrave të tij”*.

Në Kreun II, të këtij ligji, parashikohet mbrojtje e posaçme nga diskriminimi në fushën e punësimit. Ligji 10221/2010 *“Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”*, i ndryshuar, në nenin 12/1/c, ku përcaktohet se: *“1. Ndalohej diskriminimi i personit në lidhje me të drejtën e tij për punësim. Diskriminimi përfshin çdo dallim, kufizim ose përjashtim që bazohet në shkaqet e përmendura në nenin 1 të këtij ligji dhe që, ndër të tjera, ka lidhje me: a) shpalljen e vendeve të lira të punës; b) rekrutimin dhe përzgjedhjen e punëmarrësve; c) trajtimin e punëmarrësve në vendin e punës, duke përfshirë trajtimin e tyre gjatë vendosjes ose ndryshimit të kushteve të punës, shpërblimin, përfitimet dhe mjedisin e punës, trajtimin lidhur me trajnimet profesionale ose gjatë procesit disiplinor apo lidhur me pushimin nga puna ose zgjidhjen e kontratës së punës”*, ndalon çdo lloj dallimi, kufizimi ose përjashtimi, që i bëhet një punëmarrësi në gëzimin e të drejtës për punësim, duke përfshirë trajtimin e tyre në vendin e punës.

Në përfundim të shqyrtimit të ankesës Nr. 70, datë 03.04.2024, Komisioneri jep vlerësimin dhe gjykimin e tij, vetëm për ato çështje, të cilat bëjnë pjesë në kompetencat, që këtij institucioni, i atribuohen nga ligji nr. 10221, datë 04.02.2010 *“Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”*, i ndryshuar.

A. 1 Lidhur me pretendimin e subjektit ankues, për trajtim në mënyrë të padrejtë e të pafavorshëm nga ana e Gardës së Republikës.

Si rregull, me qëllimin për të përcaktuar nëse të përfaqësuarit nga ana e subjektit ankues janë trajtuar në mënyrë të padrejtë, të pabarabartë apo të pafavorshme nga ana e Gardës së Republikës, nevojitet “krahasesi”. Në rastet dhe kushtet kur ky “krahasesi” mungon, vlerësohet nëse subjektet ankues janë trajtuar në mënyrë të padrejtë e të pafavorshme, në raport me parashikimet ligjore që normojnë marrëdhënien mes tyre dhe punëdhënësit.

Nga këqyrja e dokumentacionit dhe kronologjia e ngjarjeve dhe fakteve rezulton se:

Mbështetur në provat e administruara, subjektet ankues janë punonjës të Gardës së Republikës. Më datë 26.12.2023, janë paraqitur përpara Noterit, duke nënshkruar me vullnetin e tyre të lirë, miratimin e themelimit të Sindikatës së Gardës së Republikës së Shqipërisë. Në vijim, me kërkesë të B. N., në cilësinë e Kryetarit të Sindikatës, Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë me Vendimin nr. 4, datë 20.02.2024, vendosi regjistrimin e organizatës sindikale me emërimin Sindikata e Gardës së Republikës së Shqipërisë (GRSH) me objekt veprimtarie përfaqësimit dhe mbrojtjen e të drejtave dhe interesave ekonomike, profesionale dhe shoqërore të të gjithë anëtarëve të sindikatës të cilët janë punëmarrësit e Gardës së Republikës..

Në datën 11.03.2024, Kryetari i Sindikatës, B. N., ka vënë në dijeni përmes njoftimit zyrtar Gardën e Republikës, për regjistrimin si person juridik të Sindikatës së Gardës së Republikës së Shqipërisë dhe anëtarësisë së saj, në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë.

Neni 11 i Statutit të Sindikatës së Gardës së Republikës së Shqipërisë, përcakton se: *“Qëllimet kryesore dhe detyrat e sindikatës dhe të veprimit sindikal janë si më poshtë vijon:*

- 1. Fuqizimi i lëvizjes sindikale për mbrojtjen e lirive dhe të drejtave sindikale e interesave ekonomike, sociale, arsimore, edukative e kulturore të pjesëtarëve dhe të punonjësve tjerë të Gardës Republikës Shqipërisë.*
- 2. Mbrojtja dhe garantimi i të drejtës së punës në përputhje të me Kodin e Punës.*
- 3. Sigurimi i pagës dhe shpërblimeve tjera, në bazë të kontributit të punës, konform akteve ligjore e nënligjore që normojnë punën në Gardën e Republikës së Shqipërisë.*
- 4. Përmirësimi i kushteve të përgjithshme të punës, ngritje të vazhdueshme e standardit të kushteve të punës, dhe të jetesës së anëtarëve të saj.*
- 5. Sigurimi i legjislacionit demokratik bashkëkohor, i cili garanton dhe sanksionon mbrojtjen dhe avancimin e të drejtave dhe interesave të pjesëtarëve e të punonjësve të Gardës aktiv dhe jo aktiv.*
- 6. Ngritjen e nivelit arsimor dhe të kualifikimit profesional në përputhje me kërkesat e vendeve vakante të punës.*
- 7. Aftësimi dhe edukimi sindikal i anëtarëve, aktivistëve dhe përfaqësuesve të Sindikatës.*
- 8. Formulimi dhe mbrojtja e kontratave kolektive sa më të favorshme në emër dhe për llogari të anëtarëve të saj.*
- 9. Mbrojtja e të drejtave të fituara në punë dhe nga marrëdhënia e punës.*
- 10. Mbrojtja nga veprimet burokratike dhe arbitrare të autoriteteve të punëdhënësit.*
- 11. Negocimi dhe ndërmjetësimi në zgjidhjen e mosmarrëveshjeve eventuale, individuale ose kolektive të anëtarëve të sindikatës ndaj punëdhënësit.*
- 12. Përmirësimi i vazhdueshëm i sigurimeve shoqërore e shëndetësore, përmes legjislacionit përkatës.*
- 13. Ndihmë juridike, dhe përfaqësim falas i anëtarëve të sindikatës në mbrojtjen e të drejtave dhe interesave të tyre legjitime që rrjedhin nga pasoja e neglizhimit të punëdhënësit kundrejt vartësve të tyre.*
- 14. Forcimi i solidaritetit sindikal në shkallë kombëtare e ndërkombëtare.*
- 15. Kujdesi për anëtarët e pensionuar, veçmas për ata që janë invalid, gjatë e për shkak të ish marrëdhënies së punës tyre në Gardë.*

16. Veprimi sindikal në parimin e të drejtës së punës e të drejtës sociale.
17. Kultivimi i frymës tolerante demokratike e pluraliste në aktivitetin sindikal.
18. Luftimi i korrupsionit, kriminalitetit dhe dukurive e sjelljeve tjera negative.
19. Kontributi në sundimin e ligjit njësor për të gjithë qytetarët.
20. Respektimi mbrojtja e lirive dhe të drejtave themelore, elementare të njeriut pa dallim mbi ç'farë do bazë”.

Në përmbushje të qëllimeve dhe veprimit sindikal, më datë 25.03.2024, në televizionin MCN TV, rezulton se përfaqësues të Sindikatës së Gardës së Republikës së Shqipërisë, përkatësisht Kryetari, B. N., Kryetarja e Rrjetit të Gruas, M. H. dhe Zëvendëskryetari, A. Ll., kanë dhënë intervistë¹² duke ngritur shqetësimet e punonjësve të Gardës së Republikës, sa i përket kushteve të punës dhe pagesës së orëve shtesë. Intervista e dhënë prej tyre është transmetuar në edicionin e lajmeve. Në përmbajtje të fjalës së mbajtur, nga përfaqësuesit e Sindikatës është cituar respektivisht ndër të tjera se:

- M. H. është shprehur: “...Punën time në këtë institucion, që për mua është shumë i nderuar dhe unë e dua shumë, e kam nisur llogaritare e armatimit, prej 6 vite e ca. Puna në Gardë është e vështirë sepse varet nga cili sektor përfaqësohesh, domethënë ku e kryen ti atë shërbim në Gardën e Republikës ose punë që kryen në Gardën e Republikës. Në rast se do jesh pjesë e administratës nuk është shumë e vështirë. Ka edhe pjesë të tjera për shembull, siç është rasti i Trup Shërbimi, që i takon i jashtëm, që merret kryesisht me ruajtjen e objekteve, aty ka një vështirësi për femrën. Femra në Gardën e Republikës është si uji i pakët i themi ne. Pse kam vazhduar, kam vazhduar se unë në radhë të parë e pëlqej institucionin e Gardës së Republikës, por dhe arsyeja tjetër ka qenë pamundësia ime për të ushtruar detyrën time, punësimin tim”.
- B. N., ndër të tjera shton se: “...Një pjesë dërmuese e punonjësve të Gardës së Republikës, mos të themi 70 %, janë në punë edhe në festa zyrtare, për të cilat bazuar në Kodin e Punës duhet të paguhet me 150 % të pagës. Plus asaj duhet të marrin dhe jo më vonë se 3 ditë të javës pasardhëse pushimin që i takon. Ky detyrim nuk përmbushet nga punëdhënësi, në rastin konkret Garda e Republikës. Shërbimet e Gardës kanë një numër të konsiderueshëm të punonjësve të cilët janë në punë 24 orë, me turne kuptohet, dhe shpërblimi i tyre konform Kodit të Punës është i cunuar”.
- A. Ll., thekson në intervistë se: “...Infrastruktura e Gardës së Republikës në shërbimet e Gardës së Republikës është amortizuar e para viteve `90. Ka raste kur punonjësit, sidomos edhe femrat mbingarkohen me orë shtesë. Do ishte interesante sikur të bëhej një konfederatë e tillë, vullneti është, por le t’ia lëmë kohës”.

Pas këtij momenti, përmes shkresës “Njoftim për fillimin e ecurisë disiplinore”, datë 02.04.2024, nga ana e Sektorit të Informimit të Brendshëm dhe Standardeve Profesionale, të Gardës së Republikës, janë njoftuar përfaqësuesit e Sindikatës të cilët kishin dhënë intervistat sipërcituar. Sipas shkresave dërguar atyre, dalja publike e pa autorizuar dhe dhënia e intervistës në një kanal

¹² <https://www.youtube.com/watch?v=DpOqCi-Efnc>

televiziv përbën shkelje të disiplinës, pasi kanë cenuar rëndë imazhin dhe integritetin e institucionit në opinionin publik, si dhe veprimet e tyre bien ndesh me nenet 167, germa c), 171, germa o) dhe p) të VKM me Nr. 777, datë 15.12.2023 “Për miratimin e Rregullores së Gardës”. Gjithashtu, në përmbajtje të tyre përfaqësuesit e Sindikatës janë njoftuar se:

- Komisar B. N., me detyrë Shef Seksioni në Sektorin e Parë në Njësinë e Parë, se ndaj jush ka filluar hetimi disiplinor për shkak të shkeljes së disiplinës, me motivacionin: “Në datën 25.03.2024 në kanal televiziv MCN në edicionin e lajmeve jeni shfaqur duke dhënë një intervistë ku ndërmjet të tjerave keni ngrinit problemet e mëposhtme:
 - a) Në gardën e Republikës nuk paguhen ditët e festave zyrtare në masën 150 % të pagës sipas Kodit të punës;
 - b) Nuk u jepen ditët e pushimit për punonjësit që kryejnë punë në ditët e festave zyrtare”.
- Inspektor A. Ll., me detyrë Trup Shërbimi në Sektorin e Parë të Njësinë së Katërt, se ndaj jush ka filluar hetimi disiplinor për shkak të shkeljes së disiplinës, me motivacionin: “Në datën 25.03.2024 në kanal televiziv MCN në edicionin e lajmeve jeni shfaqur duke dhënë një intervistë ku ndërmjet të tjerave keni ngrinit problemet e mëposhtme:
 - a) Infrastruktura në Gardën e Republikës është e amortizuar e para viteve `90;
- Inspektore M. H., me detyrë Trup Shërbimi në Sektorin e Parë në drejtorinë për Sigurinë e Organeve të Drejtësisë, se ndaj jush ka filluar hetimi disiplinor për shkak të shkeljes së disiplinës, me motivacionin: “Në datën 25.03.2024 në kanal televiziv MCN në edicionin e lajmeve jeni shfaqur duke dhënë një intervistë”.

Në të njëjtën ditë, më datë 02.04.2024, Garda e Republikës ka njoftuar anëtarët e tjerë të Sindikatës të cilët janë bërë pjesë e saj, se ndaj tyre ka filluar hetimi disiplinor duke argumentuar në shkresat përkatëse se: “Ju keni marrë pjesë në formimin e Sindikatës së Gardës, mbas verifikimeve paraprake të rrethanave konstatojmë se veprimet tuaja si anëtarë të lëvizjes sindikaliste të Gardës së Republikës së Shqipërisë, bien ndesh me nenin 158, pika 13, germa dh) të VKM me nr. 777, datë 15.12.2023 “Për miratimin e Rregullores së Gardës””.

Mbështetur në provat e administruara, Komisioneri konstaton se hetimi disiplinor për pjesëmarrje dhe anëtarësim në Sindikatën e Gardës së Republikës së Shqipërisë i është bërë me dije punonjësve si më poshtë:

- M. G.;
- H. P.;
- F. I.;
- E. L.;
- G. M.;
- B. D.;
- G. H.

Në vijim, mbështetur në provat e vëna në dispozicion, nga ana e strukturave të Gardës së Republikës, pas procedurave të intervistimit të ndjekura me anëtarët e Sindikatës, janë dhënë masat disiplinore si më poshtë:

- B. N., me Urdhrin nr. 395, datë 24.04.2024, i është dhënë masa disiplinore *“Përjashtim nga Garda e Republikës”*, mbështetur në nenin 16, pikën g) të nenit 30, dhe nenit 56 të Ligjit Nr. 33/2021, datë 16.03.2021 *“Për Gardën e Republikës së Shqipërisë”*, nenet 147, 148, 149 dhe 150 të Rregullores së Gardës së Republikës, pika 1 dhe 5 e nenit 160, pika 1 dhe 2 e nenit 162, pika 1 germa “a” e nenit 165, germa “c” e nenit 167, pika 2, germa “c” e nenit 170, gjerat “o” dhe “p” e nenit 171 të Rregullores së Gardës së Republikës së Shqipërisë, miratuar me VKM nr. 777, datë 15.12.2021.
- M. H., me Urdhrin nr. 397, datë 24.04.2024, i është dhënë masa disiplinore *“Shtyrje e afatit të gradimit dy vjet”*, mbështetur në nenin 16, nenit 56 të Ligjit Nr. 33/2021, datë 16.03.2021 *“Për Gardën e Republikës së Shqipërisë”*, nenet 147, 148, 149 dhe 150 të Rregullores së Gardës së Republikës, miratuar me VKM nr. 777, datë 15.12.2021.
- Ndërsa ndaj anëtarëve të tjerë sipërcituar të Sindikatës, Garda e Republikës mbështetur në nenin 158, pika 13, germa dh), të Rregullores së Gardës së Republikës së Shqipërisë, miratuar me VKM-në nr. 777, datë 15.12.2021, mori masën disiplinore *“Vërejtje”*, me motivacionin: *“Për shkelje të rregullave të etikës (sillet në mënyrë të pahijshme në jetën private, duke cenuar imazhin dhe besimin te Garda)”*.
- Gjithashtu, ndaj M. H., mbështetur në nenin 158 të Rregullores së Gardës së Republikës së Shqipërisë, me shkresën datë 26.03.2024, Garda e Republikës, mori masën disiplinore *“Vërejtje”*, me motivacionin: *“...për mos zbatim të urdhrit apo detyrës, kur kjo nuk ka sjellë pasoja, në shkelje të etikës dhe profesionalizmit neni 158, pika 3, germa “dh”, duke u anëtarësuar në sindikatën e gardistit”*.

Së pari, në referim të veprimeve të sipërcituara të Gardës së Republikës dhe strukturave të saj, Komisioneri më poshtë do të analizojë aktet normative në fuqi në Republikën e Shqipërisë që trajtojnë dhe rregullojnë organizimin sindikal.

Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë, në nenin 50 të saj, sanksionon se: *“Të punësuarit kanë të drejtë të bashkohen lirisht në organizata sindikale për mbrojtjen e interesave të tyre të punës.”*

Në nenin 51, të saj Kushtetuta, përcakton se: *“1. E drejta e të punësuarit për grevë që ka të bëjë me marrëdhëniet e punës, është e garantuar.*

2. Kufizime për kategori të veçanta të punësuarish mund të vendosen me ligj për t’i siguruar shoqërisë shërbimet e domosdoshme.”

Ligji Nr. 7961, datë 12.7.1995 *“Kodi i Punës së Republikës së Shqipërisë”*, i ndryshuar, në dispozitat e tij, ka parashikuar në mënyrë të qartë, liritë dhe të drejtat e punëmarrësve për tu organizuar në sindikata.

Neni 10, i Kodit të Punës, parashikon se: “1. Liria sindikale mbrohet me ligj. 2. Askush nuk ka të drejtë:

- a) të kushtëzojë punësimin e punëmarrësit nëse ai është ose jo ose pushon së qenuri anëtar i një sindikate të krijuar në bazë të ligjit;
- b) të pushojë ose cenojë të drejtën e punëmarrësit për shkak të anëtarësimit ose jo në një sindikatë të krijuar në bazë të ligjit ose të pjesëmarrjes në veprimtari sindikale duke respektuar legjislacionin në fuqi”.

Neni 176, “Organizatat sindikale dhe organizatat e punëdhënësve”, përcakton se: “1. Organizatat sindikale dhe organizatat e punëdhënësve janë organizata shoqërore të pavarura, që krijohen si bashkime vullnetare të punëmarrësve ose punëdhënësve, qëllimi i të cilave është përfaqësimi dhe mbrojtja e të drejtave dhe interesave ekonomikë, profesionalë dhe shoqërorë të anëtarëve të tyre”.

Neni 178, “Fitimi i Personalitetit Juridik”, parashikon se: “1. Organizatat sindikale dhe organizatat e punëdhënësve, federatat dhe konfederatat duhet të dorëzojnë aktin e krijimit dhe statutin e tyre në Gjykatën e Tiranës për njohjen e tyre si person juridik.”

Përsa më sipër, Sindikata e Gardës së Republikës së Shqipërisë, mbështetur në dokumentacionin e administruar, ka fituar personalitetin juridik, referuar Vendimit nr. 4, datë 20.02.2024, të Gjykatës së Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë.

Neni 181, “Parimet”, i Kodit të Punës parashikon se: “1. Organizata sindikale organizon lirisht administrimin dhe veprimtarinë e saj; ajo harton lirisht programin e saj.

2. Çdo organizatë sindikale duhet të zhvillojë veprimtarinë e saj në përputhje me legjislacionin në fuqi.

3. Ndalohet diskriminimi ndaj përfaqësuesve të sindikatës.

4. Zgjidhja e kontratës së punës, nga punëdhënësi, për përfaqësuesit e organizatës sindikale, pa pëlqimin e kësaj organizate, është e pavlefshme. Përfaqësuesit e organizatës sindikale mund të mos japin pëlqimin për zgjidhjen e kontratës, nëse zgjidhja e kontratës shkel parimin e trajtimit të barabartë ose kur dëmton rëndë ose e bën të pamundur funksionimin normal të sindikatës.

Kërkesës së punëdhënësit për dhënien e pëlqimit të organizatës sindikale i kthehet përgjigje brenda 8 ditëve, nga organi përkatës i kësaj organizate. Punëdhënësi mund të zgjidhë kontratën e punës nëse organizata sindikale jep pëlqimin e saj ose kur gjykata e shpall të pabazuar mosdhënien e këtij pëlqimi. Nëse punëdhënësi nuk respekton procedurën e parashikuar në këtë pikë, zgjidhja e kontratës së punës konsiderohet e pavlefshme...”.

Neni 184, i Kodit të Punës, përcakton se: “1. Ndalohet çdo akt ndërhyrjeje në krijimin, funksionimin ose administrimin e organizatave profesionale nga organet shtetërore.

2. Ndalohet çdo akt ndërhyrjeje në krijimin, funksionimin ose administrimin e organizatave sindikale nga punëdhënësit ose organizatat e punëdhënësve”.

Neni 186, përcakton se: “1. Konsiderohen si veprime ndërhyrjeje të punëdhënësit ose të një organizate punëdhënësisht masat që:

- a) nxisin krijimin e organizatave sindikale që mbizotërohen nga një punëdhënës ose një organizate punëdhënësisht ose që mbështesin organizata sindikale me mjete financiare apo mënyra të tjera, me qëllim që t’i vendosin këto organizata nën kontrollin e një punëdhënësi ose organizate punëdhënësisht;
- b) pengojnë krijimin, funksionimin ose administrimin e një organizate sindikale;
- c) dëmtojnë punëmarrësin për shkak të përkatësisë ose veprimtarisë së tij sindikale, duke e diskriminuar atë”.

Ligji Nr. 33/2021 “Për Gardën e Republikës së Shqipërisë”, në Nenin 11, “Kufizimet”, parashikohet se: “Punonjësit të Gardës i ndalohet:

- a) anëtarësimi dhe pjesëmarrja në veprimtaritë e partive ose të shoqatave politike, në çdo formë që shfaqen ato, në nivel qendror ose vendor, si dhe propaganda në favor ose kundër tyre apo kandidatëve në zgjedhje;
- b) manifestimi i sjelljeve dhe mbajtja e qëndrimeve që cenojnë statusin e punonjësit të Gardës;
- c) pjesëmarrja në grevë”.

Neni 30, “Ndërprerja e marrëdhënieve të punës dhe rikthimi”, citon: “1. Punonjësi i Gardës ndërpret marrëdhëniet e punës kur lirohet ose përjashtohet në rastet si më poshtë:

- a) kur mbush moshën për pension pleqërie;
- b) deklarohet i paaftë për punë nga organi kompetent mjekësor;
- c) i miratohet kërkesa për lirim;
- ç) lë shtetësinë shqiptare;
- d) i hiqet ose i kufizohet zotësia për të vepruar me vendim gjykate;
- dh) bëhen shkurtime në funksionet organike dhe në numrin e përgjithshëm të punonjësve;
- e) kur ka vlerësime të performacës në punë dhe të rezultateve të testimeve të nivelit nën mesatar për 2 (dy) herë rresht;
- ë) dënohet me vendim gjyqësor të formës së prerë për kryerjen e një vepre penale;
- f) shkel betimin;
- g) cenon rëndë integritetin e institucionit;
- gj) nuk paraqitet në detyrë pa shkaqe të justifikuara për më shumë se 7 (shtatë) ditë pune”.

Neni 55, “Sjellja dhe etika”, përcakton se: “1. Punonjësi është i detyruar të respektojë rregullat e sjelljes e të etikës gjatë përmbushjes së detyrave.

2. Normat dhe rregullat e sjelljes dhe të etikës përcaktohen në rregulloren e Gardës.

Neni 56, “Shkeljet dhe masat disiplinore”, përcakton se: “1. Shkelje disiplinore është çdo veprim ose mosveprim i punonjësit, që bie në kundërshtim me këtë ligj dhe rregulloren e Gardës.

2. Shkeljet disiplinore kategorizohen në shkelje të lehta dhe të rënda.

3. Punonjësi që kryen shkelje disiplinore ndëshkohet: a) për shkelje të lehta disiplinore me masat:
 - i. vërejtje;
 - ii. vërejtje me paralajmërim.
- b) për shkelje të rënda disiplinore me masat:
 - i. mbajtje deri në 1/3 e pagës së plotë mujore;
 - ii. shtyrje e afatit të gradimit deri në 2 (dy) vjet;
 - iii. përjashtim nga Garda e Republikës.
4. Masa disiplinore shuhet pas kalimit të këtyre afateve:
 - a) 6 (gjashtë) muaj nga njoftimi i masës “vërejtje”;
 - b) 1 (një) vit nga njoftimi i masës “vërejtje me paralajmërim”;
 - c) pas mbarimit të afatit për të cilin është zbatuar masa disiplinore “shtyrje e afatit të gradimit deri në 2 (dy) vjet”.
5. Efektet e masës disiplinore për punonjësin fillojnë pas përfundimit të procesit disiplinor, ku përfshihet edhe procedura përkatëse e ankimit.
6. Punonjësi administrativ për shkeljet e kryera ndëshkohet me masë disiplinore të përcaktuar në kontratën e punës.
7. Procedurat për zbatimin e këtij neni përcaktohen në rregulloren e Gardës”.

Në zbatim të Ligjit Nr. 33/2021 “Për Gardën e Republikës së Shqipërisë”, me Vendimin nr. 777, datë 15.12.2021, Këshilli i Ministrave ka miratuar Rregulloren e Gardës së Republikës së Shqipërisë.

Neni 148, “Kriteret për dhënien e masave disiplinore”, i Rregullores, në pikat 1 dhe 2, përcakton se: “1. Masat ndëshkimore, kategorizimi dhe afatet e shuarjes së tyre parashikohen në ligjin “Për Gardën e Republikës”.

2. Masat ndëshkimore jepen të përshkallëzuara sipas nivelit të shkeljes së kryer dhe në çdo rast të argumentuara.”

Neni 149 “Motivacioni i dhënies së masave disiplinore”, përcakton se: “1. Masa disiplinore duhet të jetë e motivuar dhe vetëm për shkeljet që parashikohen në ligj dhe në këtë rregullore.

2. Masa disiplinore “vërejtje” jepet në këto raste:

- a) për shkelje të rregullave të etikës e komunikimit me eprorin, vartësit, kolegët, apo qytetarët;
- b) për mosmbajtje të uniformës konform rregullores;
- c) për shkelje të rregullave të shërbimit kur kjo nuk ka sjellë pasoja;
- ç) për paraqitje me vonesë në punë apo shërbim, kur kjo nuk ka sjellë pasoja;
- d) për moszbatim të urdhrat apo detyrës, kur kjo nuk ka sjellë pasoja.

Në Nenin 158, “Etika dhe profesionalizmi”, të Rregullores së Gardës së Republikës së Shqipërisë, parashikohet se: “13. Punonjësi gjatë veprimtarisë së përditshme duhet të zbatojë normat e sjelljes, si më poshtë vijon: ...dh) të mos angazhohet dhe të mos marrë pjesë në asnjë veprimtari politike, partiake, sindikale, tubime, mitingje;”.

Në analizë të dispozitave ligjore sipërcituar, rezulton se Rregullorja e Gardës së Republikës së Shqipërisë, miratuar me Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 777, datë 15.12.2021, në nenin 158, pika 13, germa dh), ndalon angazhimin e punonjësve të Gardës për të marrë pjesë në veprimtari sindikale.

Neni 116, i Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, në nenin 1 të tij parashikon se: *“1. Aktet normative që kanë fuqi në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë janë:*

a) Kushtetuta;

b) marrëveshjet ndërkombëtare të ratifikuara;

c) ligjet;

ç) aktet normative të Këshillit të Ministrave.”

Mbështetur në hierarkinë e sanksionuar në Kushtetutë, aktet normative të Këshillit të Ministrave, ku bën pjesë edhe VKM-ja nr. 777, datë 15.12.2021 *“Për miratimin e Rregullores së Gardës së Republikës së Shqipërisë”*, janë renditur të fundit sa i përket rëndësisë dhe fuqisë që kanë. Në këtë kuptim, pavarësisht faktit që nga ana e Rregullores së Brendshme të saj është sanksionuar ndalimi i veprimtarisë sindikale dhe pjesëmarrja në të, ky ndalim vjen në kundërshtim me aktet normative me fuqi juridike më të lartë në hierarki dhe për këtë arsye ai nuk duhet të zbatohet nga Garda e Republikës.

Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë, në nenin 17 të saj ka sanksionuar se: *“1. Kufizime të të drejtave dhe lirive të parashikuara në këtë Kushtetutë mund të vendosen vetëm me ligj për një interes publik ose për mbrojtjen e të drejtave të të tjerëve. Kufizimi duhet të jetë në përpjesëtim me gjendjen që e ka diktuar atë.*

2. Këto kufizime nuk mund të cenojnë thelbin e lirive dhe të të drejtave dhe në asnjë rast nuk mund të tejkalojnë kufizimet e parashikuara në Konventën Europiane për të Drejtat e Njeriut.”

Në analizë të parashikimit të sipërcituar, ndalimi i pjesëmarrjes në veprimtari sindikale, i përcaktuar në VKM-në nr. 777, datë 15.12.2021 *“Për miratimin e Rregullores së Gardës së Republikës së Shqipërisë”*, është në kundërshtim me sa sanksionohet në nenin 17 dhe në frymën e Kushtetutës së RSH-së në tërësi për të drejtën e punëmarrësve për tu organizuar dhe marrë pjesë në organizata sindikale. Në këtë kuptim, e drejta për tu organizuar në sindikata dhe marrë pjesë në to, është një e drejtë e sanksionuar në aktet normative më të larta në hierarki të Republikës së Shqipërisë (Kushtetuta, Kodi i Punës, si edhe Ligji *“Për Gardën e Republikës së Shqipërisë”*, etj) të cilat nuk parashikojnë në asnjë dispozitë të tyre përjashtimin apo ndalimin e punonjësve të Gardës së Republikës nga të drejtat themelore të tyre për tu anëtarësuar apo organizuar në Sindikatën e Gardës së Republikës së Shqipërisë.

Në përfundim të arsyetimit sa më lart, marrja e masave disiplinore ndaj anëtarëve të Sindikatës së Gardës së Republikës së Shqipërisë, është e kundërligjshme dhe ka ardhur si pasojë e mosrespektimit, si dhe në kundërshtim të akteve normative sipërcituar. Ky veprim i kundërligjshëm i Gardës së Republikës, në cilësinë e punëdhënësit, ka sjellë pasojat të rënda në

ushtrimin e misionit dhe veprimtarisë së Sindikatës dhe anëtarëve të saj, në kundërshtim të hapur edhe me nenin 184 të Kodit të Punës, sipërcituar.

Së dyti, në referim të veprimeve të sipërcituara të Gardës së Republikës dhe strukturave të saj, Komisioneri më poshtë do të analizojë Rregulloren e Gardës në raport me masat disiplinore të dhëna ndaj punonjësve, B. N. dhe M. H.

Në Nenin 136, “Ndërprerja e marrëdhënieve të punës” të Rregullores së Gardës, parashikohet se: “1. Punonjësi ndërpret marrëdhëniet e punës kur lirohet ose përjashtohet nga Garda.

2.....

3. Punonjësi përjashtohet nga Garda në rastet kur:

- a) *dënohet me vendim gjyqësor të formës së prerë, për kryerjen e një vepre penale;*
- b) *shkel betimin;*
- c) *cenon rëndë integritetin e institucionit;*
- ç) *nuk paraqitet në detyrë pa shkaqe të justifikuara për më shumë se 7 (shtatë) ditë pune... ”.*

Neni 149 “Motivacioni i dhënies së masave disiplinore”, përcakton se: “...

5. Masa disiplinore “shtyrje e afatit të gradimit deri në 2 (dy) vjet” jepet në këto raste:

- a) *për përsëritje të së njëjtës shkelje të ndëshkuar më parë me masën “mbajtje deri në 1/3 e pagës së plotë mujore”, qoftë edhe pasi kjo masë është shuar;*
- b) *ka kryer veprime që cenojnë dinjitetin ose integritetin e institucionit;*
- c) *për shkelje të rregullave të shërbimit në mënyrë të përsëritur apo kur ka krijuar premisa për të sjellë pasoja të rënda;*
- ç) *ka manifestuar mangësi të theksuara në menaxhimin e strukturës që drejton;*
- d) *moszbatim të urdhrit apo detyrës, në mënyrë të përsëritur.*

6. Masa disiplinore “përjashtim nga Garda e Republikës” jepet në këto raste:

- a) *dënohet me vendim gjyqësor të formës së prerë, për kryerjen e një vepre penale;*
- b) *shkel betimin;*
- c) *cenon rëndë integritetin e institucionit;*
- ç) *nuk paraqitet në detyrë pa shkaqe të justifikuara për më shumë se 7 (shtatë) ditë pune;*
- d) *për përsëritje të së njëjtës shkelje të ndëshkuar më parë me masën “shtyrje e afatit të gradimit deri në 2 (dy) vjet”, qoftë edhe pasi kjo masë është shuar;...”.*

Neni 160, “Konfidencialiteti dhe e drejta për informim”, përcakton se: “1. Informacionet konfidenciale që punonjësi ka për shkak të detyrës, duhet të mbahen të fshehta.

2. *Mbledhja, ruajtja, dhe përdorimi i të dhënave personale nga punonjësit do të kryhen në përputhje me parimet e mbrojtjes së të dhënave dhe, në veçanti, do të kufizohen në masën e nevojshme për kryerjen e qëllimeve të ligjshme.*

3. *Punonjësi jep informacionin që qytetarët kërkojnë nëse ky informacion nuk është i klasifikuar. Nëse informacioni i kërkuar nga qytetari nuk është kompetencë e punonjësit, ky i fundit e orienton qytetarin drejt punonjësit përgjegjës për dhënien e këtij informacioni. Nëse për shkak të*

konfidencialitetit një punonjës nuk mund të zbulojë informacionin e kërkuar, ai i përgjigjet personit se informacioni është i klasifikuar.

4. Për kërkesat për informacion që lidhen me një tjetër institucion apo organ të administratës publike, punonjësi i Gardës e ndihmon kërkuuesin duke e drejtuar tek institucioni apo organi përkatës.

5. Gjatë marrëdhënies së punës dhe pas përfundimit të saj, ndalohet publikimi apo përhapja e informacioneve jopublike që lidhen me personalitetet ose Gardën, për të cilat është marrë dijeni gjatë detyrës. Ndalohet gjithashtu përdorimi i këtij informacioni për përfitime personale... ”.

Neni 162, “Kuptimi i shkeljeve disiplinore”, përcakton se: “1. Shkelje disiplinore vlerësohet çdo veprim, mosveprim, sjellje apo qëndrim që bie në kundërshtim me rregullat e etikës së Gardës, përcaktimet e bëra në këtë rregullore, si dhe me akte të tjera ligjore dhe nënligjore, objekt i punës së Gardës.

2. Punonjësi është i detyruar të respektojë rregullat e sjelljes e të etikës gjatë përmbushjes së detyrave”.

Neni 167, “Pakujdesia në detyrë”, përcakton se: “Punonjësi është përgjegjës për pakujdesi në detyrë nëse:

a) nuk përgatit apo shfaq vonesa të përsëritura, në përgatitjen e raporteve ose informacioneve që kanë të bëjnë me detyrën;

b) gjatë komunikimit, keqpërdor radiolidhjen dhe mjetet e tjera të komunikimit të Gardës;

c) pa autorizim, u jep informacion mediave dhe personave të paautorizuar;... ”.

Neni 170, “Kategoritë e shkeljeve të rënda disiplinore”, përcakton se: “1. Shkelje e rëndë disiplinore konsiderohet veprimi ose mosveprimi i punonjësit të Gardës, punonjësit që bashkëpunon me të, ose atij që nxit kryerjen e shkeljeve, që ka sjellë pasoja të rënda dhe është kryer në kushtet e rrethanave rënduese.

2. Shkelje e rëndë disiplinore, konsiderohet:

a) sjellja e rëndë diskredituese;

b) mosbindja e rëndë;

c) nxjerrja e paautorizuar e informacionit;... ”.

Neni 171, “Sjellja e rëndë diskredituese”, përcakton se: “Punonjësi është përgjegjës për sjellje të rëndë diskredituese, nëse:...

o) bën kritika publike ndaj eprorëve;

p) shpif, intrigon dhe bën akuza të pavërtetuara për punonjësit e Gardës, në ambientet publike, brenda dhe jashtë ambienteve të Gardës;... ”.

Në analizë të informacionit të administruar dhe parashikimeve të Rregullores së Gardës, rezulton se:

- Referuar motivacionit për masat disiplinore të dhëna ndaj B. N. dhe M. H., Rregullorja në tërësinë e saj ndalon:
 - ✓ *përhapjen e informacioneve konfidenciale nga punonjësit e Gardës, gjatë dhe pas përfundimit të marrëdhënieve të punës;*
 - ✓ *nxjerrjen e pa autorizuar të informacionit;*
 - ✓ *bërjen e kritikave publike ndaj eprorëve;*
 - ✓ *shpifjen, intrigat dhe akuzat e pavërtetuara për punonjësit e Gardës, në ambientet publike, brenda dhe jashtë ambienteve të Gardës*
- Gjithashtu, Rregullorja bën përgjegjës punonjësin e Gardës, për pakujdesi në detyrë nëse, pa autorizim, u jep informacion mediave dhe personave të paautorizuar.

Sakaq, nga informacioni i administruar dhe në analizë të intervistave të dhëna në televizionin MCN, më datë 25.03.2024, Komisioneri vlerëson se, në cilësinë e përfaqësuesve të Sindikatës së Gardës së Republikës së Shqipërisë, përkatësisht Kryetari, z. B. N.; Kryetarja e Rrjetit të Gruas, M. H. dhe Zëvendëskryetari, A. Ll., kanë dhënë intervistë¹³ duke ngritur shqetësimet e punonjësve të Gardës së Republikës, sa i përket kushteve të punës dhe pagesës së orëve shtesë. Intervista e dhënë prej tyre është transmetuar në edicionin e lajmeve.

Në përmbajtje të intervistave të tyre, në asnjë moment nuk citohen:

- *informacioneve konfidenciale;*
- *kritika publike ndaj eprorëve;*
- *shpifje, intriga apo akuzat të pavërtetuara;*

Referuar përcaktimeve të Rregullores së Gardës në nenin 167, germa c), punonjësi i Gardës është përgjegjës, për pakujdesi në detyrë nëse, pa autorizim, u jep informacion mediave dhe personave të paautorizuar. Në këtë kuptim, në interpretim të kësaj dispozite, vlerësohet se punonjësi i Gardës, kur është në detyrë, pra gjatë ushtrimit të detyrave funksionale të tij, pa autorizimin e eprorëve, u jep informacion palëve të treta, mediave apo dhe personave të paautorizuar.

Pra, nga përmbajtja e intervistave të anëtarëve të Sindikatës sipërcituar, nuk rezulton e provuar se ata:

- gjatë ushtrimit të detyrës kanë dhënë apo shpërndarë, informacione konfidenciale të Gardës;
- kanë kritikuar në mënyrë të drejtpërdrejtë eprorët e tyre apo duke cituar një prej tyre;
- apo kanë shpifur, bërë intriga apo akuza të pavërteta ndaj punëdhënësit.

Intervistat e tyre janë mbështetur në përmbushjen e misionit dhe qëllimit për të cilën është ngritur dhe funksionon Sindikata e Gardës së Republikës së Shqipërisë, si dhe në mbrojtje të të drejtave të anëtarëve të saj. Garda e Republikës së Shqipërisë, në asnjë moment nuk vuri në dispozicion një dokument përmes së cilit të provojë se përmbajtja e intervistave të B. N., M. H. dhe A. Ll., ka patur synim të dëmtojë imazhin e Gardës, të shpif apo të përhapë informacione konfidenciale.

¹³ <https://www.youtube.com/watch?v=DpOqCi-Efnc>

Në përfundim të arsyetimit sa më lart, marrja e masave disiplinore ndaj anëtarëve të Sindikatës së Gardës së Republikës së Shqipërisë, është e kundërligjshme dhe ka ardhur si pasojë e mosrespektimit, si dhe në kundërshtim të akteve normative sipërcituar në këtë vendim. Ky veprim i kundërligjshëm i Gardës së Republikës, në cilësinë e punëdhënësit, ka sjellë pasoja të rënda në ushtrimin e misionit dhe veprimtarisë së Sindikatës dhe anëtarëve të saj, në kundërshtim të hapur edhe me nenin 184 të Kodit të Punës, sipërcituar.

Gjithashtu, nuk rezulton e provuar se nga ana e z. B. N., M. H. dhe A. Ll., me veprimet ose mosveprimet e tyre, gjatë ushtrimit të detyrës, të kenë shkelur detyrimet kontraktuale me faj të rëndë, duke u dhënë informacion mediave dhe personave të paautorizuar, pa autorizim, të cilat do të përlligjnin masat disiplinore të dhëna ndaj tyre.

Neni 181, i Kodit të Punës ka parashikuar se: *“Zgjidhja e kontratës së punës, nga punëdhënësi, për përfaqësuesit e organizatës sindikale, pa pëlqimin e kësaj organizate, është e pavlefshme..... Përfaqësuesit e organizatës sindikale mund të mos japin pëlqimin për zgjidhjen e kontratës, nëse zgjidhja e kontratës shkel parimin e trajtimit të barabartë ose kur dëmton rëndë ose e bën të pamundur funksionimin normal të sindikatës. Kërkesës së punëdhënësit për dhënien e pëlqimit të organizatës sindikale i kthehet përgjigje brenda 8 ditëve, nga organi përkatës i kësaj organizate. Punëdhënësi mund të zgjidhë kontratën e punës nëse organizata sindikale jep pëlqimin e saj ose kur gjykata e shpall të pabazuar mosdhënien e këtij pëlqimi. Nëse punëdhënësi nuk respekton procedure e parashikuar në këtë pikë, zgjidhja e kontratës së punës konsiderohet e pavlefshme”.*

Sa më sipër rezulton se, zgjidhja e marrëdhënieve të punës me z. B. N., i cili është Kryetar i Sindikatës dhe A. Ll., i cili është Zëvendëskryetar i saj, si dhe marrja e masës disiplinore ndaj M. H., e cila është Kryetarja e Rrjetit të Gruas, është bërë në kundërshtim me garancitë ligjore që parashikohen në kuadër të lirisë sindikale, pasi punëdhënësi Garda e Republikës nuk ka respektuar parashikimet e nenit 181 të Kodit të Punës.

Në përfundim, bazuar në analizimin e veprimeve të Gardës së Republikës, Komisioneri vlerëson se, përfaqësuesit e Sindikatës së Gardës së Republikës së Shqipërisë janë ekspozuar para një trajtimi të padrejtë dhe të paligjshëm, lidhur me masat disiplinore të dhëna ndaj tyre dhe ndërprerjes së marrëdhënieve të punës, përse i takon mbrojtjes ligjore që ata gëzojnë për tu organizuar në lëvizje sindikaliste dhe si përfaqësues të organizatës sindikale.

A. 2 Lidhur me ndalimin e punonjësve të Gardës së Republikës për të marrë pjesë në veprimtari sindikale, sipas VKM-së nr. 777, datë 15.12.2021 “Për miratimin e Rregullores së Gardës”.

Referuar nenit 158, pika 13/dh, të VKM-së Nr. 777, datë 15.12.2021 “Për miratimin e Rregullores së Gardës”, parashikohet se: *“13. Punonjësi gjatë veprimtarisë së përditshme duhet të zbatojë*

normat e sjelljes, si më poshtë vijon: ...dh) të mos angazhohet dhe të mos marrë pjesë në asnjë veprimtari politike, partiake, sindikale, tubime, mitingje;”.

Mbështetur në analizën e bërë më sipër në pjesë A.1 të këtij vendimi, e drejta sindikale është një e drejtë themelore kushtetuese e çdo punëmarrësi dhe në bazë të nenit 4, pika 3, të Kushtetutës, dispozitat e Kushtetutës zbatohen drejtpërsëdrejti përveç rasteve kur Kushtetuta parashikon ndryshe. Lidhur me të drejtën për tu organizuar në sindikatë, Kushtetuta nuk ka bërë ndonjë përjashtim për punonjësit e Gardës së Republikës, për t’ua mohuar këtë të drejtë. Në këtë rast, duhet të zbatohet gjithashtu edhe Kodi i Punës, përkatësisht neni 4 dhe nenet 10, 176-187, të cilat rregullojnë veprimtarinë sindikale dhe organizimin në to.

Në analizë të parashikimit të kësaj VKM-je, vërehet se, veprimet e Gardës së Republikës kanë cenuar të drejtën kushtetuese të punonjësve të saj për tu bërë pjesë e sindikatës.

Ligji Nr. 33/2021 “Për Gardën e Republikës së Shqipërisë”, në Nenin 11, “Kufizimet”, përcakton se: “Punonjësit të Gardës i ndalohet:

- a) anëtarësimi dhe pjesëmarrja në veprimtaritë e partive ose të shoqatave politike, në çdo formë që shfaqen ato, në nivel qendror ose vendor, si dhe propaganda në favor ose kundër tyre apo kandidatëve në zgjedhje;
- b) manifestimi i sjelljeve dhe mbajtja e qëndrimeve që cenojnë statusin e punonjësit të Gardës;
- c) pjesëmarrja në grevë”.

Pra, dispozita sipërcituar e Ligjit “Për Gardën e Republikës së Shqipërisë”, i ndalon punonjësve të Gardës vetëm pjesëmarrjen në grevë dhe jo angazhimit e tyre për tu organizuar në aktivitet sindikal.

Bazuar në sa më sipër, *prima facie*, evidentohet qartë se VKM-ja në fjalë dhe specifikisht parashikimi i nenit 158, pika 13/dh, i vendos punonjësit e Gardës së Republikës në kushte të padrejta dhe të pafavorshme sa i përket të drejtës për tu angazhuar dhe marrë pjesë në veprimtari sindikale. Ky ndalim është në kundërshtim me aktet normative të sipërcituara në këtë vendim dhe për këtë arsye nuk duhej zbatuar nga ana e Gardës së Republikës.

Sakaq, VKM-ja e sipërcituar, evidentohet se nuk është e qartë dhe e kuptueshme nga organet të cilat vendosen përpara përgjegjësisë për ta zbatuar atë. Duke qenë e paqartë, vendos përpara vështirësisë Gardën e Republikës në sjelljen që duhet të mbajnë për zbatimin e saj.

Në analizë për sa më sipër, Komisioneri konstaton se neni 158, pika 13/dh e VKM-së nr. 777, datë 15.12.2021 “Për miratimin e Rregullores së Gardës”, ku parashikohet ndalimi i punonjësve të Gardës së Republikës për të marrë pjesë në veprimtari sindikale, vendos në kushte të pafavorshme dhe të padrejta punonjësit e Gardës së Republikës së Shqipërisë.

Në përfundim, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, në respektim të parimit të barazisë dhe mosdiskriminimit, rekomandon Këshillin e Ministrave të rishikojë dhe të

formulojë në mënyrë objektive, të justifikuar dhe të qartë parashikimet e nenit 158, pika 13/dh të VKM-së nr. 777, datë 15.12.2021 “Për miratimin e Rregullores së Gardës”, duke pasur në vëmendje lirinë dhe të drejtat e punonjësve të Gardës së Republikës për të marrë pjesë në veprimtari sindikale.

B. Shkak i mbrojtur.

Subjektet ankues pretendojnë se janë diskriminuar nga Gardës së Republikës për shkak të *bindjeve filozofike, përkatësisë në një grup të veçantë, si pjesë e Sindikatës së Gardës së Republikës së Shqipërisë dhe çdo shkak tjetër*.

- i. ***Në lidhje me pretendimin për diskriminim për shkak të bindjes filozofike dhe çdo shkak tjetër***, subjektet ankues nuk vunë në dispozicion të shqyrtimit të çështjes asnjë informacion apo provë, për të argumentuar ekzistencën e këtyre shkaqeve apo se si ato kanë ndikuar në sjelljen diskriminuese të pretenduar. Për rrjedhojë, Komisioneri i vlerëson të pabazuara shkaqet e *bindjeve filozofike dhe çdo shkak tjetër*.
- ii. ***Në lidhje me pretendimin për diskriminim për shkak të përkatësisë në një grup të veçantë***, Komisioneri vlerëson se “përkatësia në një grup të veçantë”, konsiderohet si një shkak i mbrojtur, pasi parashikohet si të tillë në LMD. Nga parashtrimet e subjekteve ankues, rezulton se këtë shkak ata e lidhin me faktin që ata bëjnë pjesë dhe janë anëtarë të Sindikatës së Gardës së Republikës së Shqipërisë.

Në lidhje me pretendimin për diskriminim për shkak të përkatësisë në një grup të veçantë, Komisioneri vlerëson se ky shkak parashikohet shprehimisht si një shkak i mbrojtur nga neni 1, i LMD. Komisioneri vlerëson se, *përkatësia në një grup të veçantë si shkak diskriminimi*, nënkupton diferencën në trajtim dhe trajtimin më pak të favorshëm që një person apo grup personash i nënshtrohen për shkak të faktit që janë pjesë e një grupi që karakteristikat e tij e bëjnë atë të dallueshëm dhe mbart një veçanti që presumohet që ka ndikuar në kryerjen e sjelljes diskriminuese të pretenduar.

Në këtë kontekst, Komisioneri ka vlerësuar se ankuesit, përmes akteve të themelimit dhe regjistrimit në Gjykatë të Sindikatës së Gardës së Republikës së Shqipërisë kanë dokumentuar karakteristikat e grupit ku bëjnë pjesë, dhe në këtë logjikë do të pranojë si shkak të justifikuar të LMD-së, shkakun e përkatësisë në grup të veçantë, pasi rezulton i provuar e dokumentuar.

Gjithashtu, “anëtarësia në një organizatë sindikale” është një nga shkaqet e pranura nga GJEDNJ, në praktikën e saj, si shkak i mbrojtur (*Danilenkov dhe të tjerët kundër Rusisë, Nr. 67336/01, 30 korrik 2009; Zakharova dhe të tjerët kundër Rusisë, Nr. 12736/10, 8 mars 2022*)

Në referim të nenit nenin 9/2 të Kodit të Punës (si më sipër cituar) parashikohet në mënyrë të shprehur mbrojtja nga diskriminimi për shkak të “bashkimit ose përkatësinë në organizata sindikale.”

Referuar nenit 1, të LMD, ky shkak i pretenduar nga subjektet ankues konsiderohet si shkak i mbrojtur, dhe Komisioneri vlerëson se, kanë provuar se e justifikojnë dhe e mbartin atë. Kjo shkon në linjë edhe me praktikën e Komisionerit, i cili në mënyrë të vazhdueshme ka konsideruar si shkak të mbrojtur përkatësinë/anëtarësinë në një organizatë sindikale (vendimi nr. 202, datë 09.12.2014; vendimi nr. 92, datë 08.07.2019; vendimi nr. 176, datë 02.12.2019; vendimi nr.102, datë 7.6.2022)

C. Lidhja e trajtimit të padrejtë dhe të pafavorshëm me shkakun e mbrojtur.

C.1 Lidhja e trajtimit të padrejtë dhe të paligjshëm, të subjekteve ankues me shkakun përkatësisë në Sindikatën e Gardës së Republikës së Shqipërisë.

Komisioneri ka shqyrtuar dhe analizuar faktin, nëse ankuesit janë trajtuar në mënyrë të padrejtë e të paligjshme nga ana e Gardës së Republikës, bazuar pikërisht në shkakun që posedojnë, atë të përkatësisë në Sindikatën e Gardës së Republikës së Shqipërisë.

Parimi i barazisë dhe i mosdiskriminimit, sanksionohet nga Kushtetuta si një parim i përgjithshëm që përshkon të gjitha të drejtat dhe liritë themelore të njeriut, prandaj ai duhet të gjejë shprehjen e tij në të gjithë legjislacionin shqiptar si dhe të zbatohet nga të gjithë, si nga institucionet edhe nga individët. Ky parim përshkon edhe nenin 49 të Kushtetutës sipas të cilit “Secili ka të drejtë të fitojë mjetet e jetesës së tij me punë të ligjshme që e ka zgjedhur ose pranuar vetë. Ai është i lirë të zgjedhë profesionin, vendin e punës, si dhe sistemin e kualifikimit të vet profesional”.

Doktrina kushtetuese, e trajton të drejtën e individit për punë, duke theksuar se liria për punë mbrohet nga rregullimet kushtetuese.¹⁴ Gjykata Kushtetuese¹⁵, ka mbajtur qëndrimin se: “E drejta për punë, që garanton neni 49/1 i Kushtetutës, përfshin zgjedhjen e profesionit, vendin e punës dhe sistemin e kualifikimit profesional me qëllim sigurimin e mjeteve të jetesës në mënyrë të ligjshme. Zgjedhja e profesionit, siç parashikohet nga dispozita kushtetuese, përbën një të drejtë të individit në kuptimin, që ai i përkushtohet një veprimtarie për të siguruar mjetet e jetesës. Kjo e drejtë e individit për të përfituar me punë të ligjshme fiton rëndësi edhe nga pikëpamja sociale, pasi puna si profesion është një vlerë edhe për kontributin që i sjell shoqërisë në tërësi. E drejta për punë dhe liria e profesionit nënkuptojnë të drejtën e individit për të ushtruar çdo veprimtari të ligjshme që i sjell të ardhura dhe që nuk ka afat të përcaktuar, me përjashtim të rregullimeve të veçanta ligjore. Në këtë kuptim, veprimi i organeve shtetërore që sjell pasoja të drejtpërdrejta në pengimin e veprimtarisë profesionale përbën cenim të kësaj lirie veprimi. Garancia që Kushtetuta i jep

¹⁴ Livio Paladini, “Diritto Costituzionale”, CEDAM, Padova, 1991, fq. 166-175.

¹⁵ Vendimi nr. 20, datë 11.07.2006, i GJK.

individit lidhur me të drejtën për punë dhe lirinë e profesionit ka si qëllim mbrojtjen e këtyre nga kufizimet e papërligjura të shtetit. Liria e profesionit nuk është thjesht një e drejtë për të pasur një vend pune. Ajo nuk duhet kuptuar vetëm si e drejtë sociale, por dhe si liri negative që nuk lejon ndërhyrjen ose pengimin e shtetit gjatë ushtrimit të saj. Përcaktimi që neni 49 i Kushtetutës i bën të drejtës për punë duhet të merret në kuptim të dyfishtë. Ajo përbën një detyrim pozitiv që kërkon angazhimin shtetëror për të krijuar kushte të përshtatshme për realizimin e një të drejte të tillë, por edhe detyrim negativ, i cili kërkon mosndërhyrjen e shtetit për të cenuar këtë të drejtë”.

Parimi i mosdiskriminimit, përshkon në frymë dhe në nene Kodin e Punës, i cili në pikën 1, të nenit 9, të tij ka përcaktuar se: *“Në ushtrimin e së drejtës për punësim dhe profesion, ndalohej çdo formë diskriminimi, e parashikuar në këtë Kod dhe në legjislacionin e posaçëm për mbrojtjen nga diskriminimi”.*

Konventa Evropiane e të Drejtave të Njeriut (KEDNJ-ja), nuk parashikon të drejtën për punë si një të drejtë të veçantë, por çështjet e punës trajtohen nga Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut (GJEDNJ-ja) si çështje që hyjnë në sferën e veprimit të nenit 8, *“E drejta për respektimin e jetës private dhe familjare”*. Neni 14 i KEDNJ-së ndalon diskriminimin në gëzimin e të drejtave dhe lirive të përcaktuara në të, bazuar në një listë shoqëruese shkaqesh.

Ndërkohë Protokollin 12-të i Konventës, i cili është ratifikuar nga Shqipëria, shtrihet përtej të drejtave të mbrojtura shprehimisht nga KEDNJ. Në veçanti, fusha e mbrojtjes sipas nenit 1, të Protokollit të 12, të KEDNJ përfshin rastet kur personi është diskriminuar:

- “a) në gëzimin e çdo të drejte ligjore të njohur shprehimisht me ligj të veçantë;*
- b) në gëzimin e çdo të drejte që rrjedh nga një detyrim i qartë i autoritetit publik sipas legjislacionit të brendshëm, sa kohë autoriteti ka detyrimin të dëshmojë një sjellje të caktuar mbi bazën e ligjit të brendshëm;*
- c) nga autoriteti publik në ushtrimin e kompetencës diskrecionare;*
- d) nga çdo akt apo mosveprim tjetër i autoritetit publik”.*

E drejta për punë dhe mbrojtja nga diskriminimi në gëzimin e kësaj të drejte parashikohet edhe në akte të tjera ndërkombëtare të ratifikuara nga Shqipëria të tilla si:

“Pakti Ndërkombëtar për të Drejtat Ekonomike, Sociale dhe Kulturore¹⁶”, i cili sanksionon të drejtën për punë në nenin 6, të tij. Sipas këtij akti ndërkombëtar në fushën e të drejtave të njeriut, i cili është ratifikuar nga vendi ynë, parashikohet se, e drejta për punë përfshin të drejtën e secilit për të pasur mundësinë e sigurimit të jetesës, duke punuar punën e pranuar lirisht dhe marrjen e masave të përshtatshme për ta mbrojtur këtë të drejtë. Sipas nenit 2/2, të Paktit, të drejtat e

¹⁶ Ratifikuar me ligjin nr. 7511 datë 08.08.1991

parashikuara në këtë Pakt duhet të garantohen pa asnjë diskriminim bazuar në një listë jo shteruese shkaqesh.

Konventa Nr. 111 e Organizatës Ndërkombëtare të Punës¹⁷ “*Mbi diskriminimin në fushën e punësimit dhe profesionit*”, përcakton parimin e barazisë së mundësive dhe të trajtimit në fushën e punësimit dhe të profesionit për të gjithë individët, pa asnjë lloj diskriminimi, bazuar në një listë jo shteruese shkaqesh. Konventa e përkufizon diskriminimin si - *çdo dallim tjetër, përjashtim ose preferencë që çon në prishjen apo shtrembërimin e barazisë, të mundësisë ose trajtimit në drejtim të punësimit ose të profesionit*.

Konventa nr. C087: “*Për lirinë e asocimit dhe mbrojtjen e së drejtës së organizimit*”, përcakton se: “*Punëmarrësit dhe punëdhënësit, pa dallim, kanë të drejtë të themelojnë dhe/ose të bashkohen me organizatat e zgjedhura prej tyre pa autorizim paraprak. Në ushtrimin e të drejtave të parashikuara në këtë Konventë punëmarrësit dhe punëdhënësit, si dhe organizatat e tyre përkatëse, duhet të respektojnë ligjin e vendit. Çdo shtet anëtar i Organizatës Ndërkombëtare të Punës për të cilin kjo Konventë është në fuqi merr përsipër të ndërmarrë të gjitha masat e nevojshme për të siguruar që punëmarrësit dhe punëdhënësit të ushtrojnë lirisht të drejtën e organizimit*”.

Konventa nr. C098: “*Zbatimi i parimeve të së drejtës së organizimit dhe marrëveshjeve kolektive*”, përcakton se: “*Punëtorët gëzojnë mbrojtje të përshtatshme ndaj akteve të diskriminimit sindikal në lidhje me punësimin e tyre. Kjo mbrojtje do të zbatohet më në veçanti në lidhje me punësimin e punonjësve, me kusht që të mos bëhet anëtar i sindikatës ose të heqë dorë nga anëtarësia në sindikatë. Organizatat e punëmarrësve dhe punëdhënësve do të gëzojnë mbrojtje të përshtatshme ndaj çdo akti të ndërhyrjes nga agjentët e njëri-tjetrit ose ndaj njëri-tjetrit apo anëtarët e tyre, në procesin e krijimit, funksionimit ose administrimit të këtyre organizatave*”.

Konventa nr. C135: “*Për mbrojtjen dhe krijimin e lehtësirave për përfaqësuesit e punëtorëve*” parashikon se: “*Përfaqësuesit e punëmarrësve në ndërmarrje do të gëzojnë mbrojtje efektive kundër çdo akti të dëmshëm ndaj tyre, duke përfshirë pushimin nga puna, bazuar në statusin e tyre ose veprimtaritë si përfaqësues të punëmarrësve apo pjesëmarrjes në veprimtari sindikale, për aq kohë sa ata të veprojnë në përputhje me ligjet ekzistuese, marrëveshjet kolektive ose marrëveshje të tjera për të cilat është rënë dakord bashkërisht*”.

Karta Sociale Europiane¹⁸ në nenin 1, pika 2, parashikon: “*Me synimin që të sigurohet ushtrimi efektiv i së drejtës për punë, Palët angazhohen.....2 të mbrojnë efektivisht të drejtën e punëtorit për të fituar jetesën e tij në një punë në të cilën ka hyrë lirisht...*” Ky parashikim, është interpretuar vazhdimisht nga Komiteti Evropian i të Drejtave Sociale (KEDS) si vendosje e një të drejte për të mos u diskriminuar në punësim¹⁹. Garancitë për mbrojtjen nga diskriminimi

¹⁷ Ratifikuar me ligjin nr. 8086, datë 13.03.1996.

¹⁸ Ratifikuar me ligjin nr. 8960, date 24.10.2002.

¹⁹ Shih: *Sidabras dhe Džiautas kundër Lituanisë*, prg 30.

parashikohen në nenin E), Pjesa V, të Kartës Social Europiane, ku përcaktohet shprehimisht mbrojtja nga diskriminimi për bazuar në një listë të hapur shkaqesh.

Ligji “*Për Mbrojtjen nga Diskriminimi*”, i ndryshuar, parashikon shprehimisht parimin e barazisë përpara ligjit dhe mosdiskriminimin, parime të cilat janë të ndërthurura ngushtë. Parimi i barazisë kërkon që situata të barabarta trajtohen në mënyrë të barabartë dhe situata të jo të barabarta të mënyrë të ndryshme. Dështimi për ta bërë këtë, konsiderohet diskriminim, përveç nëse ekzistojnë arsye objektive dhe të arsyeshme²⁰.

Sipas nenit 3, pika 1 të LMD diskriminimi përkufizohet si, çdo dallim, përjashtim, kufizim ose preferencë, bazuar në cilindo shkak të mbrojtur në nenin 1 të këtij ligji, që ka si qëllim ose pasojë pengesën ose bërjen e pamundur të ushtrimit në të njëjtën mënyrë me të tjerët, të të drejtave e lirive themelore të njohura me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, me aktet ndërkombëtare të ratifikuara nga Republika e Shqipërisë, si dhe me ligjet në fuqi.

Një nga format e diskriminimit parashikuar nga LMD, është *diskriminimi i drejtpërdrejtë*, i cili përkufizohet nga neni 3/2, i ligjit si një *situatë diskriminimi që ndodh kur një person apo grup personash trajtohen në mënyrë më pak të favorshme sesa një person tjetër, apo një grup tjetër personash në një situatë të njëjtë a të ngjashme, bazuar në cilindo shkak të mbrojtur në nenin 1 të këtij ligji*. Bazuar në nenin 9/1, të Kodit të Punës, ndalohet çdo formë diskriminimi në ushtrimin e të drejtës për punësim dhe profesion, sipas parashikimeve të bëra në Kod dhe ligjin e posaçëm për mbrojtjen nga diskriminimi.

Gjykata Kushtetuese në disa vendime të saj ka interpretuar nenin 18 të Kushtetutës, si dhe ka theksuar se parimi i barazisë synon që të gjithë të jenë të barabartë në ligj dhe përpara ligjit, jo vetëm në të drejtat themelore të parashikuara në Kushtetutë por edhe në të drejtat e parashikuara nga ligjet e tjera në fuqi. Gjykata është shprehur se: “*Barazia në ligj dhe para ligjit nuk do të thotë që të ketë zgjidhje të njëllota për individë ose kategori personash që janë në kushte objektivisht të ndryshme. Barazia përpara ligjit dhe në ligj presupozon barazinë e individëve që janë në kushte të barabarta*”, si dhe “*Vetëm në raste përjashtimore dhe për shkaqe të arsyeshme dhe objektive mund të përligjet trajtimi i ndryshëm i kategorive të caktuara që përfitojnë nga kjo e drejtë*” (vendimet nr. 39, datë 16.10.2007, nr. 4 datë 12.02.2010, nr. 34, datë 20.12.2015, të Gjykatës Kushtetuese)

Gjithashtu, Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut (GJEDNJ), në mënyrë të vazhdueshme ka interpretuar se trajtimi i diferencuar është diskriminues nëse ai nuk bazohet në ndonjë justifikim objektiv dhe të arsyeshëm, domethënë, nëse trajtimi i diferencuar nuk ndjek një qëllim legjitim ose nëse nuk ekziston një marrëdhënie e arsyeshme të proporcionalitetit ndërmjet mjeteve të përdorura dhe qëllimit që synohet të realizohet²¹.

²⁰ Raporti Shpjegues që shoqëron Protokollin 12 të KEDNJ-së, prg 15.

²¹ Shiko: *Molla kundër Greqisë*, Vendim i Dhomës së Madhe, 2018, prg. 135; *Fábián kundër Hungarisë*, Vendim i Dhomës së Madhe 2017, prg. 113; *Abdulaziz, Cabales dhe Balkandali kundër Mbretërisë së Bashkuar*, 1985, prg.72.

Në të njëjtën frymë edhe në bazë të LMD, jo çdo dallim apo ndryshim i trajtimit konsiderohet diskriminim. Në nenin 6, të tij, përcaktohet se: *“Ndalimi i diskriminimit i përshkruar nga ky ligj nuk zbatohet në rastet kur ka një qëllim objektivisht të justifikueshëm dhe të përligjur në bazë të Kushtetutës, të marrëveshjeve apo akteve ndërkombëtare të ratifikuara nga republika e Shqipërisë dhe legjislacioni në fuqi”*.

Në shumicën e çështjeve të diskriminimit, ankuesi e ka të vështirë apo të pamundur t’i mbledhë provat, ndonjëherë provat e drejtpërdrejta as nuk ekzistojnë. Subjektet që konsumojnë sjelljen diskriminuese nuk e pranojnë asnjëherë se kanë diskriminuar. Për të kompensuar këtë disavantazh të madh, legjislacioni ka parashikuar parimin e zhvendosjes së barrës së provës.

Parimi i zhvendosjes së barrës së provës është një parim i konsoliduar në legjislacionin e BE-së dhe jurisprudencën e GJEDNJ-së. KEDS²² gjithashtu ka pranuar që në çështjet e diskriminimit, barra e provës nuk duhet të varet plotësisht nga ankuesi, por duhet të jetë objekt i një rregullimi të posaçëm. Bazuar në nenin 9/10 të Kodit të Punës, barra e provës në çështjet e diskriminimit është objekt i një rregullimi të posaçëm.

Kështu, në nenin 9, pika 10, të Kodit të Punës, parashikohet se: *“Në të gjitha procedurat e ankimit, që ndiqen sipas pikës 9, të këtij neni, nëse ankuesi ose paditësi paraqet fakte nga të cilat mund të pretendohet se është diskriminuar në ushtrimin e së drejtës për punësim dhe profesion, personi ndaj të cilit paraqitet ankesa ose i padituri detyrohet të provojë se nuk është shkelur parimi i trajtimit të barabartë”*.

Neni 33, pika 7/1 e LMD, ka parashikuar se: *“Në rastet kur pala ankuese paraqet fakte mbi të cilat bazon pretendimin për sjelljen diskriminuese dhe në bazë të të cilave mund të prezumohet se ka pasur diskriminim, pala tjetër, kundër së cilës është paraqitur ankesa, detyrohet të provojë se faktet nuk përbëjnë diskriminim”*.

Në aspektin procedural, si fillim pala ankuese duhet të provojë se, i vetmi shpjegim i arsyeshëm për trajtimin e diferencuar është shkak i mbrojtur nga diskriminimi dhe në kushtet kur arrihet ky nivel provueshmërie barra e provës për të provuar të kundërtën, që veprimet nuk përbëjnë diskriminim i bie palës tjetër. Pra, nëse faktet e prezantuara nga ankuesi duken të besueshme dhe në përputhje me provat në dispozicion, GJEDNJ në praktikën e vet i ka pranuar ato si të provuara, përveçse kur pala tjetër kundër së cilës paraqitet ankesa paraqet një shpjegim alternativ bindës.

GJEDNJ-ja pranon si fakte ato vlerësime *“...të mbështetura nga vlerësimi i lirë i të gjitha provave.....provat mund të vijnë nga bashkëekzistenca e deduksioneve/prezumimeve mjaftueshmërisht të forta, të qarta dhe të përputhshme apo nga prezumime faktesh të pa*

²² Komiteti Evropian për të Drejtat Sociale.

kundërshtuara. Për më tepër niveli i bindjes i nevojshëm për arritjen e një konkluzioni të veçantë dhe lidhur me këtë, shpërndarja e barrës së provës, janë të lidhura ngushtësisht me veçoritë e fakteve, natyrën e pretendimit të bërë dhe me të drejtat e pretenduara²³”.

Duke qenë se pala kundër të cilës drejtohet ankesa disponon gjithë informacionin dhe dokumentacionin e nevojshëm për të provuar bazueshmërinë e pretendimeve, legjislacioni i ka transferuar barrën e provës palës kundër të cilës është paraqitur ankimi, kur vihet re se *prima facie* është ngritur një pretendim për diskriminim. Pala kundër të cilës është paraqitur ankesa ka barrën e provës të provojë se trajtimi i diferencuar nuk është diskriminues.

Sa më sipër, ankuesi duhet të krijojë një prezumim të diskriminimit (diskriminimi *prima facie*), barra më pas kalon tek subjekti që pretendohet se ka kryer diskriminimin, i cili duhet të tregojë se ndryshimi në trajtim nuk është diskriminues. Kjo mund të bëhet:

1. Ose duke vërtetuar se nuk ka ndonjë lidhje shkakësore midis shkakut/shkaqeve të mbrojtur dhe trajtimit të pafavorshëm apo të padrejtë.
2. Ose duke demonstruar që megjithëse ky trajtim është i lidhur me shkakun/shkaqet e pretenduar, ka një justifikim të arsyeshëm dhe objektiv. Nëse Garda e Republikës, që pretendohet se ka konsumuar sjelljen diskriminuese nuk është në gjendje të provojë njërën nga të dyja, atëherë do të jetë përgjegjëse për diskriminimin.²⁴

Komisioneri çmon të nevojshme të theksojë se, është bazuar pikërisht në standardin e mësipërm të të provuarit, gjatë shqyrtimit dhe konkluzioneve të arritura, në lidhje me bazueshmërinë e pretendimeve për diskriminim të parashtruara në këtë ankesë.

Në analizë sa më sipër, Komisioneri vlerëson se jemi para situatës së prezumimit të diskriminimit dhe si pasojë barra e provës bie mbi punëdhënësin Garda e Republikës i cili duhet të provojë se trajtimi i padrejtë dhe i pafavorshëm të cilit i janë nënshtruar ankuesit nuk ka ardhur për shkakun e diskriminimit të pretenduar prej tyre.

Punëdhënësi Garda e Republikës ka pranuar se trajtimi i subjekteve ankues është bazuar pikërisht në faktin që ata janë anëtarësuar në veprimtari sindikale dhe janë prononcuar në media në cilësinë e përfaqësuesve të tyre dhe rrjedhimisht kjo lidhet me përkatësinë në Sindikatën e Gardës së Republikës së Shqipërisë.

Nga dinamika dhe kronologjia e zhvillimit të ngjarjeve, analizimi i fakteve në tërësinë e tyre, rezulton se, pasojat negative për ankuesin kanë ardhur pas anëtarësimit të tyre në Sindikatë dhe prononcimit në media të drejtuesve në cilësinë e përfaqësuesve të saj.

²³ GjEDNJ *Nachova dhe të tjerët v. Bullgarisë* [GC] (Nr. 43577/98 dhe 43579/98), 6.07.2005, para. 147. GjEDNJ, *Timishev v. Rusisë* (Nr.s. 55762/00 and 55974/00), 13.12.2005, para. 39, dhe GjEDNJ, *D.H.dhe të tjerët v. Republikës Çeke* [GC] (Nr. 57325/00), 13.11.2007, para. 178.

²⁴ https://fra.europa.eu/sites/default/files/fra_uploads/fra-2018-handbook-non-discrimination-laë-2018_en.pdf, fq.232.

Nga provat e administruara, Komisioneri konstaton se sapo është vënë në dijeni të regjistrimit në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, të Sindikatës së Gardës së Republikës së Shqipërisë dhe ngritjes së strukturave të saj, Garda e Republikës, në cilësinë e punëdhënësit ka nisur menjëherë procedurat për dhënien e masave disiplinore ndaj anëtarëve të saj. Njëkohësisht, në rolin përfaqësuesve të saj, përkatësisht Kryetari, B. N.; Kryetarja e Rrjetit të Gruas, M. H. dhe Zëvendëskryetari, A. Ll., kanë nisur të evidentojnë përmes daljeve në media problematikat që lidhen me kushtet e punës së punonjësve të Gardës. Për këtë, Garda e Republikës, pavarësisht faktit që këto subjekte daljen e tyre në media e kanë bërë në cilësinë e përfaqësuesve të Sindikatës, ndaj tyre ka filluar ecuria disiplinore dhe janë marrë masa disiplinore të përjashtimit nga Garda të Kryetarit dhe Zëvendëskryetarit të saj, si dhe shtyrje të afatit të gradimit për 2 vjet për Kryetaren e Rrjetit të Gruas.

Lidhur me sa më sipër, si dhe në analizë të rastit konkret, Komisioneri gjykon se, justifikimi i përdorur nga punëdhënësi për masat disiplinore të dhëna ndaj anëtarëve të Sindikatës së Gardës së Republikës së Shqipërisë, janë haptazi të paligjshme si dhe në kundërshtim me të drejtat e tyre ligjore, normuar nga legjislacioni për marrëdhëniet e punësimit.

Në këtë kuadër, Komisioneri vlerëson se, Garda e Republikës nuk arriti të provojë me dokumentacion apo prova të tjera që subjektet ankues nuk janë trajtuar në mënyrë të padrejtë dhe të pafavorshme, në raport me parashikimet ligjore që normojnë marrëdhënien mes tyre dhe punëdhënësit.

Komisioneri konstaton se:

- Zgjidhja e marrëdhënieve të punës me z. B. N., i cili është Kryetar i Sindikatës dhe A. Ll., i cili është Zëvendëskryetar i saj, si dhe marrja e masës disiplinore ndaj M. H., e cila është Kryetarja e Rrjetit të Gruas, është bërë në kundërshtim me garancitë ligjore që parashikohen në kuadër të lirisë sindikale, pasi punëdhënësi Garda e Republikës nuk ka respektuar parashikimet e nenit 181 të Kodit të Punës;
- Marrja e masave disiplinore ndaj anëtarëve të Sindikatës së Gardës së Republikës së Shqipërisë, është e kundërligjshme dhe ka ardhur si pasojë e mosrespektimit, si dhe në kundërshtim të akteve normative sipërcituar në këtë vendim. Ky veprim i kundërligjshëm i Gardës së Republikës, në cilësinë e punëdhënësit, ka sjellë pasoja të rënda në ushtrimin e misionit dhe veprimtarisë së Sindikatës dhe anëtarëve të saj, në kundërshtim të hapur edhe me nenin 184 të Kodit të Punës, sipërcituar.

Komisioneri konstaton se veprimet e sipërcituara ndaj anëtarëve të Sindikatës së Gardës së Republikës së Shqipërisë nga ana e Gardës së Republikës, nuk kanë ardhur për arsye të justifikuara.

Në çështjen Zakharova dhe të tjerët kundër Rusisë²⁵, GJEDNJ mban qëndrimin se: “...(Si në përputhje me qëndrimet e Komitetit Evropian të të Drejtave Sociale dhe Organizatës Ndërkombëtare të Punës) barra e provës do t'i bartej punëdhënësit, pasi aplikantët të kishin demonstruar një rast *prima facie* të diskriminimit. (shih gjithashtu Baka kundër Hungarisë). I takon punëdhënësit, që zakonisht ka kontroll mbi provat përkatëse, të demonstrojë ekzistencën e arsyeve legjitime për shkarkimin e aplikantëve”.

GJEDNJ, në çështjen në fjalë, shprehet se: “Megjithatë, kur vlerësohen faktet në tërësi, është vërtet e vështirë t'i shpëtosh pikëpamjes se punëdhënësi jo vetëm që ka neglizhuar në mënyrë flagrante të drejtën e për t'u organizuar, por edhe më aktivisht i është rikthyer praktikave të patolerueshme për të fshehur arsyet e vërteta për largimin e punonjësve nga posti i tyre, vetëm në bazë të veprimtarisë së tyre sindikale. Pavarësisht se parimi i afirmanti incumbit probatio zakonisht zbatohet si standard, vetëm një ndryshim i barrës së provës mund të rezultojë në ruajtjen e lirisë për t'u organizuar të punonjësve. Nëse nuk do të ishte kështu, do të ishte jashtëzakonisht e vështirë për ta të provonin diskriminimin”.

GJEDNJ-ja ka mbajtur qëndrimin se, sapo të jetë e qartë *prima facie* se diskriminimi nga punëdhënësi bazuar në anëtarësimin në sindikatë të një punonjësi, barra e provës i kalon punëdhënësit për të provuar e kundërta. Kjo shkon në të njëjtën linjë me pikëpamjet e ILO-s që rrjedhin nga 'liria e organizimit dhe negociatat kolektive' si parimet e saj themelore dhe të zbatuara në Deklaratën e ILO-s mbi Parimet dhe të Drejtat Themelore në Punë. (Konventa C087 - Liria e Asociimit dhe Mbrojtja e Konventës për të Drejtën e Organizimit dhe Konventës C098 – Konventa për të Drejtën për Organizim dhe Marrëveshje Kolektive).

Në çështjen Zakharova and të tjerët kundër Rusisë, GJEDNJ konsideron se, aplikantët i përkisnin një grupi të mbrojtur (anëtarë dhe drejtues të një sindikate) dhe se ata pësuan veprime negative nga ana e punëdhënësit të tyre, pikërisht bazuar në këtë shkak dhe se sindikalizmi i tyre mund të kishte luajtur një rol kryesor në mënyrën se si ata ishin trajtuar nga punëdhënësi i tyre. Prandaj, ekziston një rast *prima facie* i diskriminimit ndaj aplikantëve për shkak të anëtarësimit të tyre në sindikatë dhe aktiviteteve të lidhura me to. GJEDNJ-ja ka mbajtur qëndrimin se shteti nuk e ka trajtuar ankesën e aplikantëve për diskriminim me vëmendjen e duhur, në mënyrë që të sigurojë mbrojtje reale dhe efektive nga veprimet e punëdhënësve kundër sindikatave.

GJEDNJ i referohet në vendimin e saj Përmbledhjes së vendimeve dhe parimeve të Komitetit të Lirisë së Organizimit të Organizatës Ndërkombëtare të Punës (ILO), ku ndër të tjera parashikohet:

- diskriminimi kundër sindikatave është një nga shkeljet më të rënda të lirisë së organizimit, pasi mund të rrezikojë vetë ekzistencën e sindikatave;

²⁵ Aplikimi me nr. 17030/04, Vendim i GJEDNJ-së, Maj 2022.

- asnjë person nuk duhet të pushohet nga puna ose të paragjykohet në punësim për shkak të anëtarësisë në sindikatë ose veprimtarive të ligjshme sindikaliste;
- duhet të sigurohet mbrojtja e zyrtarëve të sindikatave, me kusht që ata të mos shkarkohen, as gjatë periudhës së tyre të detyrës, as për një kohë të caktuar pas kësaj, përveç, natyrisht, për sjellje të pahijshme serioze;
- të merren masat për të garantuar mbrojtjen efektive të përfaqësuesve të punëtorëve, me miratimin e dispozitës për kalimin e barrës së provës mbi punëdhënësin, në rast të çdo shkarkimi të pretenduar diskriminues ose ndryshim të pafavorshëm të kushteve të punësimit të përfaqësuesit të punëtorëve.

Neni 186, pika 1, shkronja c) e Kodit të Punës, parashikon se: *“Konsiderohen si veprime ndërhyrjeje të punëdhënësit ose të një organizate punëdhënësisht masat që: c) dëmtojnë punëmarrësin për shkak të përkatësisë ose veprimtarisë së tij sindikale, duke e diskriminuar atë”*.

Ndalimi i diskriminimit dhe mbrojtja ligjore e punëmarrësit në cilësinë e anëtarit apo përfaqësuesit të sindikatës garantohet nga një sërë aktesh të tjera ligjore e nënligjore që rregullojnë marrëdhënien e punës mes Gardës së Republikës/punëdhënësi dhe anëtarëve të Sindikatës.

Bazuar në aktet shkresore të vëna në dispozicion nga palët, deklaratimet e tyre, si dhe në analizën e legjislacionit që rregullon marrëdhëniet e punës mes punëmarrësve/subjekteve ankues dhe punëdhënësit/Gardës së Republikës, Komisioneri krijon bindjen se, procedura e ndjekur sa i përket veprimeve të marra ndaj anëtarëve të Sindikatës, nuk motivohet nga shkaqe ligjore dhe nuk ndjek një qëllim të ligjshëm apo të jetë e justifikuar objektivisht. Përkundrazi ato bien ndesh dhe janë në kundërshtim me gjithë mbrojtjen ligjore që parashikohet nga legjislacioni kombëtar e ndërkombëtar, përsa i takon gëzimit të së drejtës së ankuesve në marrëdhëniet e punësimit.

Në analizë të sa më sipër, Komisioneri evidenton se në rastin konkret, shkak i përkatësisë në *sindikatë/Sindikatën e Gardës së Republikës së Shqipërisë*, ka ndikuar duke bërë që trajtimi i padrejtë dhe i pafavorshëm i subjekteve ankues, të lidhet drejtpërdrejtë me këtë shkak/cilësi të subjekteve ankues.

Puna është një veprimtari jetike e individëve të aftë për punë. Ajo është burimi i të ardhurave që ata sigurojnë mjetet e jetesës. Gjithashtu, marrëdhënia e punës (*punësimi*) është, përveç të tjerash, një marrëdhënie sociale dhe shoqërore. Punëdhënësi ka detyrimin të respektojë dhe të mbrojë në raportet e punës personalitetin e punëmarrësve, si dhe të marrë të gjitha masat e nevojshme për të garantuar sigurinë, mbrojtjen e shëndetit mendor dhe fizik të tyre, si dhe trajtimin me dinjitet të tij.

E drejta për punë buron nga Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë. Në kushtet kur ndalimi i diskriminimit është një e drejtë kushtetuese, e detyrueshme për t’u zbatuar drejtpërsëdrejti nga institucionet, është një e drejtë e sanksionuar dhe e mbrojtur shprehimisht me ligjin nr. 10221 datë 04.02.2010 *“Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”*, të ndryshuar, është e natyrshme që kjo e drejtë

vendos detyrime negative mbi çdo punëdhënës që krijon, ndryshon apo i jep fund marrëdhënies së punës, të ndërmarrë veprime në përputhje me të drejtën e punëmarrësve për mbrojtjen nga diskriminimi.

Për të qenë përpara një veprimi diskriminues në kuptim të këtij ligji, Komisioneri vlerëson se, duhet të plotësohen tre kushte njëherësh:

- Të ekzistojë trajtimi i diferencuar i ankuesit në raport me të tjerët në kushte, rrethana të njëjta apo të ngjashme;
- Trajtimi i diferencuar të ketë ndodhur për një/disa nga shkaqet e parashikuara në nenin 1, të këtij ligji;
- Trajtimi i diferencuar të ketë sjellë si pasojë vështirësinë apo pamundësinë e ankuesit për të ushtruar të drejtat dhe liritë e njohura nga kushtetuta, aktet ndërkombëtare të ratifikuara apo ligjet e tjera në fuqi.

Në përfundim të analizimit të çështjes në tërësi, Komisioneri vlerëson se, përmbushen të tria këto kushte njëherësh dhe se, trajtimi i padrejtë dhe më pak i favorshëm i subjekteve ankues nuk ka një justifikim të ligjshëm dhe objektiv.

Në konkluzion të sa më sipër, Komisioneri konstaton se Garda e Republikës ka diskriminuar subjektet ankueses në të drejtën e tyre për punësim, pasi marrja e masave disiplinore ndaj tyre dhe zgjidhja e marrëdhënieve të punës²⁶, nuk ka ndodhur bazuar në një shkak të ligjshëm, nuk ka ndodhur për arsye të ligjshme dhe objektive, si dhe nuk ka ndjekur një qëllim të ligjshëm, por është bërë për shkaqe të mbrojtura nga LMD, përkatësinë në sindikatë. Për rrjedhojë, Garda e Republikës, ka shkelur dispozitat e ligjit nr. 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, respektivisht, nenin 3, pikat 1, 2, 3, nenin 3/1, nenin 5 dhe nenin 12, pika 1, shkronja c, të tij.

Bazuar në nenin 33, pika 10 të ligjit nr. 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, përcaktohet se: “Vendimi përmban rregullimet dhe masat e duhura, duke caktuar edhe një afat për kryerjen e tyre”, ndërsa bazuar në nenin 33, pika 12, të po këtij ligji, përcaktohet se: “Kur vendos masën, komisioneri siguron që ajo të jetë: a) e efektshme dhe parandaluese; dhe b) në përputhje me gjendjen që e shkaktoi vendosjen e masës”.

Ligji nr. 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, i ndryshuar, në nenin 33/10 të tij, nuk ka përcaktuar masat që duhen marrë për rregullimin e situatës diskriminuese, por e ka lënë në diskrecionin e Komisionerit. Pra, Komisioneri rast pas rasti, vendos se cilat janë rregullimet dhe masat që duhen marrë në mënyrë që të sigurojë mbrojtjen efektive nga diskriminimi të personave që pretendojnë se janë viktima të diskriminimit. Ky ligj, përmes nenit 33/12, ka vendosur kriteret që duhet të ndjekë Komisioneri, në përcaktimin e masës që ai jep nëpërmjet vendimeve të tij.

²⁶ Për B. N. dhe A. Ll.

Komisioneri vlerëson se masa e duhur për rregullimin e situatës diskriminuese të shkaktuar si pasojë e largimit nga puna të 2 prej subjekteve ankues, B. N. dhe A. Ll., duhet të jetë rivendosja në vend e të drejtës së shkelur, duke i rikthyer në vendin e mëparshëm të punës, përmes shfuqizimit të urdhrave të përjashtimit të tyre nga Garda e Republikës. Gjithashtu, masa e duhur për rregullimin e situatës diskriminuese të shkaktuar si pasojë masave disiplinore “Vërejtje” për anëtarët e Sindikatës dhe shtyrje të afatit të gradimit për 2 vjet për Kryetaren e Rrjetit të Gruas, M. H., duhet të jetë rivendosja në vend e të drejtës së shkelur, përmes shfuqizimit të menjëhershëm të tyre nga Garda e Republikës.

PËR KËTO ARSYE :

Bazuar në nenet 32 dhe 33 të ligjit nr. 10221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

V E N D O S I :

1. Konstatimin e diskriminimit të anëtarëve themelues të Sindikatës së Gardës së Republikës së Shqipërisë, në të drejtën për punësim dhe profesion, për shkak të përkatësisë në sindikatë, nga ana e Gardës së Republikës.
2. Konstatimin e diskriminimit të B. N., M. H. dhe A. Ll., në të drejtën për punësim dhe profesion, për shkak të përkatësisë në sindikatë, nga ana e Gardës së Republikës.
3. Në referim të pikës 1 dhe 2, Garda e Republikës, të marrë masa për rivendosjen në vend të të drejtës së shkelur të anëtarëve themelues të Sindikatës duke shfuqizuar në mënyrë të menjëhershme masat disiplinore “Vërejtje” dhe “Shtyrje të afatit të gradimit për 2 vjet” për M. H.
4. Në referim të pikës 2, Garda e Republikës, të marrë masa për rivendosjen në vend të të drejtës së shkelur duke rikthyer në vendin e mëparshëm të punës B. N. dhe A. Ll.
5. Rekomandohet Këshilli i Ministrave, që në respektim të parimit të barazisë dhe mosdiskriminimit, të marrë masat për rishikimin dhe riformulimin në mënyrë objektive, të justifikuar dhe të qartë, të parashikimeve të nenit 158, pika 13/dh të VKM-së nr. 777, datë 15.12.2021 “Për miratimin e Rregullores së Gardës”, duke pasur në vëmendje lirinë dhe të drejtat e punonjësve të Gardës së Republikës për të marrë pjesë në veprimtari sindikale.
6. Bazuar në nenin 33 pika 11, të ligjit “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, Garda e Republikës, detyrohet që brenda 30 (tridhjetë) ditëve të njoftojë Komisionerin, lidhur me veprimet e ndërmarra për zbatimin e këtij vendimi.
7. Në referim të nenit 33, pika 11, të ligjit nr. 10221, datë 04.02.2010, “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, moszbatimi i këtij vendimi sjell si pasojë ndëshkimin me gjobë, sipas parashikimeve të pikës 13, të po këtij neni.
8. Kundër këtij vendimi lejohet ankim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, brenda 45 ditëve nga marrja dijeni.

KOMISIONERI

Robert GAJDA

(Shkaku: Për shkak të përkatësisë në sindikatë)
(Fusha: Punësim)